



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË
PROGRAMI I MAGJISTRATURËS: DREJTIMI JURIDIKO –
CIVIL

TEZA E MAGJISTRATURËS:

“Zgjidhja gjyqesore e kontesteve tregtare ne Maqedone e Veriut me theks te vecante ne territorin e Gjykates themlore te Gostivarit ne periudhen 2015 - 2020”.

KANDIDATI:

Samije Idrizi

MENTORI:

Prof.Dr. Adnan Jashari

Tetovë, 2022

Deklaratë

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull “**ZGJIDHJA GJYQESORE E KONTESTEVE TREGTARE NE MAQEDONE E VERIUT ME THEKS TE VECANTE NE TERRITORIN E GJYKATES THEMLORE TE GOSTIVARIT NE PERIUDHEN 2015 -2020**”. është punuar nga unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas rregullave të caktuara për një punim të mirëfilltë shkencor.

Ky punim i dedikohet - Familjes sime

E veçanarisht vajzës time

Me respekt dhe dashuri!

Samiya

Falënderime

Falënderimi i takon Zotit për shëndetin, vullnetin dhe për çdo mirësi që më dhuroj që të arrijë sukses dhe të përmbush ëndrrën time.

Falënderim të veçantë për familjen time, që më mbështetën dhe më përkrahën në vendimet e mia dhe në çdo hap të jetës sime, jam falënderuese tërë jetën ndaj tyre dhe shpresoj që do të arrij të i bëj krenar dhe më tutje.

Për finalizimin e punimit e falënderoj shumë mentorin e temës, Prof. Asoc. Dr. Adnan Jashari, i cila me gatishmërinë në dhënien e këshillave dhe sugjerimeve më ka ofruar mbështetje të pakursyer profesionale.

Falënderoj komisionin për vlersimin e punimit tim dhe po ashtu UEJL-n që më dha mundësinë të jemë student në të.

Përmbajtja.

Deklarata e autorsisë.....	2
Falemenderime.....	4
Përmbajtja.....	5
Abstrakt.....	8
Lënda e hulumtimit.....	10
Qëllimi i hulumtimit.....	10
Metodologjia e hulumtimit.....	11
Rëndësia e punimit.....	11
Pjesa hyrëse.....	13

KREU I

NË PËRGJITHËSI MBI KONTESTET TREGTARE

1.Kuptimi i kontesteve tregtare.....	14
1.1.Mënyrat e zgjedhjes së kontesteve.....	15
1.2.Palet te kontestet tregtare.....	16
Përfaqësuesit ligjor.....	17
Përfaqësuesit e përkohshëm.....	17
Përfaqësuesi i autorizuar nga palët.....	17
2.Llojet e kontesteve tregtare.....	18
2.1.Kontestet midis shoqerive tregtare.....	18
2.2..Kontestet ne lidhje me falimentimin.....	18

2.3.Kontestet ne lidhje me pasurite e paluajtshme te shoqerive tregtare.....	19
2.4.Kontestet ne lidhje me pengim posedimin midis shoqerive tregtare.....	20

KREU II

NE PERGJITHESI PER PROCEDUREN KONTESTIMORE

1.Kuptimi.....	21
2 Procedura para gjykatës së shkallës së parë.....	22
2.2.Përgatitja e shqyrtimit kryesor.....	25
2.3.Shqyrtimi kryesor.....	31
2.4.Shqiptimi i vendimit përfundimtar.....	36
3. Procedura sipas mjeteve juridike.....	39
3.1.Mjetet e rregullta juridike.....	39
3.2.Mjetet e jashtëzakonshme juridike.....	41

KREU III

ZGJIDHJA GJYQESORE E KONTESTEVE TREGTARE NE MAQEDONINE E

VERIUT

1.Procedura e kontesteve tregtare.....	43
Procedura e ndërmjetësimit.....	44
Procedura e urdhërpagesës.....	47
2.Inicimi i procedurës në shkallë të parë.....	50
2.1. Kompetenca vendore dhe reale.....	50
2.2.Zhvillimi.....	52

2.3.Perfundimi.....	55
2.Inicimi i procedures ne shkalle te dyte.....	57
2.1.Ankesa.....	58
2.2.Zhvillimi.....	59
2.3.Perfundimi.....	60
3.Inicimi i procedures ne Gjyaketen supreme.....	63
3.1.Revizioni	64
3.2.Përsëritja e Procedurës.....	68

KREU IV

ANALIZE TE VENDIMEVE TE SHQIPTUARA NGA GJYKATA THEMLORE E GOSTIVARIT NE PERIUDHEN 2015-2020

1.Analize te akvendimit numër 1	71
2.Analize te vendimit numër 2.....	73
3.Analize te vendimit numër 3	74
4.Analize te vendimit numër 4.....	75
5.Analize te vendimit numër 5	76
Bibliografija.....	78

ABSTRAKT

Qëllimi i këtijë punimi është të jap një pasqyrë për zgjidhjen e kontesteve tregatre, procedurave të kontestetve tregatre , mënyrat e zgjidhjes së kontesteve tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për realizimin e qëllimit janë pordorur të dhëna primare dhe sekondare të cilat janë të analizuar me metoda statistike, përshkruese dhe krahasuese. Ne mes palëve gati se çdo ditë lindin konteste kjo si arsyeje e shkeljes së një të drejte.

Në mes tyre lindin të drejta dhe detyrime, mos plotsimi i këtyre detyrimeve sjell deri në kontest, ku ne kontestet tregatre paraqitete në mes personave juridik. Kontestete tregtare rregullohen me Ligjin e Procedurës Kontestimore- LPK nëse me ligj tjetër nuk parashihet ndryshe.

Në këtë punim do të sqarohet në përgjithësi mbi kontestete tregtare dhe procedurat e zgjidhjes së këtyre kontesteve, me plotësim ligji dhe me paraqitjen e disa neneve të reja është paraqitur Procedura e Medeacioni-RRUGA DERI TE E DREJTA, ku nëpërmejet kësaj procedure palët mund ta zgjedhin kontestin e tyre në koh të shkurtë dhe me pak harxhime.

Përvec kësaj procedure paraqitet edhe Procedura e Urdhërpagesës vendimi i sjellur nga ana e noterit i cili nuk kundërshtohet nga ana e palës tjetër paraqitet si i plotfuqishëm. Procedura me padi është procedurë tjetër e cila inicohet me padi nga vet pala në gjykatën kompetente, procedura e cila mbaron me aktvendim apo aktgjykim.

Në këtë hulumtim të punimit rëndësi të veçant i është kushtuar Zgjidhjes së kontesteve tregtare në RMV e në theks të veçant në territorin e GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT NGA VITI 2015-2020.

АБСТРАКТ

Целта на овој труд е да даде преглед на решавањето на трговските спорови, постапката на трговските спорови, начините на решавање трговски спорови во Република Северна Македонија.

За постигнување на целта користени се примарни и секундарни податоци кои се анализирани со статистички, описни и споредбени методи.

Меѓу страникте секој ден се јавуваат спорови како причина за повреда на некое право. Меѓу нив произлегуваат права и обврски, неисполнувањето на овие обврски доведува до спорови, каде што настануваат трговски спорови меѓу правни лица.

Трговските спорови се уредуваат со Законот за парнична постапка - ЗПП, ако со закон не е предвидено нешто друго.

Во овој труд генерално ќе се појасни за трговските спорови и процедурите за решавање на овие спорови, со комплетирање на законот и презентирање на некои нови членови, е претставено Постапката за медијација - ВИСТИНСКИОТ ПАТ, каде што преку оваа постапка странките можат да го решават својот спор за кратко време и со мали трошоци.

Во прилог на оваа постапка се презентира Постапката за платен налог, решението донесено од нотарот на кое не се противи другата страна стана правосилно. Тужбената постапка е уште една постапка што се поведува со тужба од самата странка до надлежниот суд, постапка која завршува со решение или пресуда.

Во овој истражувачки труд посебно значење се дава на решавање на трговски спорови во РСМ и со посебен акцент на територијата на ОСНОВЕН СУД ГОСТИВАР ОД 2015-2020 ГОДИНА.

ABSTRACT

The purpose of this work is to give an overview of the settlement of commercial disputes, the procedure of commercial disputes, the methods of settlement in the Republic of North Macedonia. To achieve this goal, primary and secondary data are used, which are analyzed with statistical, descriptive and comparative methods.

Almost every day, disputes arise among the parties as a reason for the violation of some right. Between them arise rights and obligations, the non-fulfilment of these obligations leads to disputes, where disputes arise between legal entities. Commercial disputes are governed by the Law on Dispute Procedure - ЗПК, unless otherwise specified by law.

In this work, you will generally be explained about economic disputes and the procedures for resolving these disputes, by rounding up the law and presenting some new ones, Mediation Procedure - THE TRUE PATH, where through this procedure the parties can choose their dispute for a short time и со мали частови.

In addition to this procedure, the Tax Payment Procedure is presented, the decision delivered by the notary, which is not opposed by the other side, is presented as a whole.

The sued procedure is another procedure that starts with a lawsuit from the same side to the competent court, a procedure that ends with a decision or verdict.

In this research work, special importance was given to the resolution of economic disputes in the Republic of Moldova and with an emphasis on the vacancy in the territory of the BASIC COURT FROM 2015-2020.

LËNDA E HULUMTIMIT

Kryesisht në temën e sipërshenuar do të jepet rëndësi definimit të kontesteve tregtare si dhe llojeve me fokus në përcaktimin e procedurave të zgjidhjes së kontesteve tregtare në shkallë të parë, shkallë të dytë dhe shkallë të tretë.

Poashtu lëndë hulumtimi do të jetë edhe trajtimi i praktikës gjyqësore në baza të analizimit të vendimeve të shiptuara nga Gjykata Themelore e Gostivarit në periudhë 2015-2020.

Theks të vecantë në këtë punim shkencor do t'i jap praktikës gjyqësore me fokus në analizimin e vendimeve nga aspekti i përcaktimit të shkaqeve për shkaktimin e kontesteve tregtare, paleve në kontesteve tregtare, zbatimit të institutëve të së drejtës civile në kontestet tregtare, realizimit të vendimeve si dhe permbarimit të tyre.

Së fundmi, pjesë e hulumtimit është edhe korniza ligjore aktuale që i rregullon çështjet në lidhje me kontestet tregtare si në aspektin material ashtu edhe në aspektin procedural.

Kjo literaturë do të na ndihmojë për të zbërthyer këtë temë dhe për të nxjerrë përfundimet e duhura.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i këtij punimi të MA është të përcaktohen konceptet si:

E para, përshkruhet përkufizimi i saktë i kontesteve tregtare, përcaktimit të përmbajtjes dhe llojeve të tyre me theks në trajtimin jo vetëm nga aspekti i legjislacionit por edhe praktikës gjyqësore.

E dyta, përshkruhen llojet e procedurave për zgjidhjen e kontesteve tregtare, edhe ato procedurat në shkallë të parë, procedurat me mjete juridike të rregullta dhe procedurat me mjete juridike të jashtëzakonshme. Normalisht fokusi do të jetë në zgjidhjen e kontesteve në Gjykatë Themelore të Gostivarit dhe Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën 2015-2020.

E treta, sqarohet permbarimi i vendimeve të plotfuqishme të vendimeve në lidhje me zgjidhjen e kontesteve tregtare.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kam vlerësuar të bëj një kombinim metodologjik, për të arritur përmbushjen e qëllimit final të këtij punimi shkencor. Kërkimi dhe përzgjedhja e literaturës, ishte një hap i parë dhe i rëndësishëm në mbledhjen e literaturës kryesore dhe ndihmëse, të përshtatshme dhe në përputhje me objektin e studimit. Fillimisht janë siguruar materialet (libra, artikuj shkencorë, punime shkencore, burime juridike aktuale), të cilat janë përzgjedhur me kujdes për të qenë jo vetëm në përputhje me objektin e studimit, por për të qenë materiale cilësore dhe me vlerë.

Metodologjia e hulumtimit të këtij punimi ngërthen: metodën juridike (dogmatike) e cila si metodë specifike përcakton në mënyrë të qartë saktësinë e normës juridike. Kjo në mënyrë të qartë vërteton se me anën e normës juridike përcaktohet sjellja e njeriut, të cilën e drejta u urdhëron njerëzve.

Metoda normative me anë të së cilës hulumtohet ana formale e normave dhe e akteve juridike duke u bazuar kryesisht në fuqinë e tyre juridike, e cila sigurohet në bazë të pozitës që norma ka në rendin juridik, pra në sistemin juridik. Metoda përshkruese është përdorur në studim, në shërbim të sqarimit të kuptimit të koncepteve të përfaqësimit në përgjithësi si dhe ato të kontratave të përfaqësimit tregtar. Metoda statistikore dhe analizuese, e cila në pjesën e statistikave dhe shembujve të paraqitur është përdorur për të vlerësuar të dhënat dhe analizuar shkaqet e përfaqësimit.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Subjektet e së drejtës gati çdo ditë hynë në marrëdhënie të ndryshme juridiko-tregtare. Nga këto marrëdhënie, për subjektet e së drejtës, lindin autorizime ose detyrime të caktuara. Megjithatë, jo çdo herë subjektet e së drejtës sillen në pajtueshmëri me autorizimet dhe detyrimet e tyre. Në raste të caktuara, subjektet e së drejtës sillen në mënyrë të kundërt me atë që është përcaktuar me norma juridike. Kjo sjell deri tek cenimi, kontestimi apo shkelja e të drejtave subjektive, respektivisht vjen deri tek tentimi që bartësi i detyrimit të lirohet nga obligimi. Në situata të tilla lind nevoja që të sigurohet realizimi i dhunshëm i normave juridike, thelbin e të cilit e përbën e drejta në mbrojtje juridike të të drejtave subjektive të përcaktuara me normat juridiko-materiale.

Në sistemet juridike bashkëkohore, mbrojtja e të drejtave, si formë e rregullt, sigurohet përmes organeve të specializuara shtetërore – gjykatave, sipas rregullave dhe në procedurë paraprakisht të përcaktuar me ligj, të cilave duhet t'u përmbahen si ato të cilët kërkojnë mbrojtjen e të drejtave ashtu edhe ato të cilët atë mbrojtje sigurojnë.

Mbrojtja e të drejtave subjektive komerciale të shkelura, kontestuar apo rrezikuara, realizohet përmes metodës së veçantë të mbrojtjes juridike të të drejtave subjektive civile – procedurës civile. Edhe pse në teori ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me ndarjen e

procedurës civile, mbrojtja e të drejtave subjektive komerciale realizohet në procedurë kontestimore, jokontestimore, përmbaruese dhe falimentuese, si metoda të posaçme të procedurës civile. Në këtë punimin, rëndësi të veçantë paraqet mbrojtja e të drejtave subjektive komerciale në procedurë kontestimore.

Procedura kontestimore paraqet metodën e përgjithshme, të rregullt dhe themelore për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile të shkelura apo rrezikuara nga ana e organeve gjyqësore. Me LPK, i cili paraqet burimin themelor të së drejtës procedurale kontestimore, janë paraparë rregullat e veprimit në bazë të të cilave gjykatat shqyrtojnë dhe vendosin ‘’në kontestet për drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit, në kontestet nga marrëdhëniet personale dhe familjare të qytetarit, si dhe në kontestet nga marrëdhëniet e punës, marrëdhëniet tregtare, pasurore si dhe në kontestet e tjera juridiko-civile, nëse me ligj nuk është paraparë se për disa nga kontestet e theksuara gjykata vendos sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër’’.

Nga kjo del se për zgjidhjen e kontesteve tregtare para gjykatave tregtare zbatohen rregullat e procedurës kontestimore, nëse me ligj nuk parashihet diçka tjetër. Andaj, në vijim do të analizojmë zgjidhjen e kontesteve në procedurë kontestimore nga ana e organeve gjyqësore, e cila njëkohësisht vlen edhe për zgjidhjen e kontesteve tregtare, me atë që në mënyrë të veçantë do të theksojmë të gjitha përjashtimet që parasheh ligji gjatë procedimit para gjykatave tregtare.

HYRJE

Kontestet tregtare janë ato konteste apo mosmarveshje që paraqiten në mes personave juridik dhe fizik.

Në mes palëve lindin të drejta dhe detyrime të caktuara që duhet të plotsohen nga persona të caktua, mos realizimi i këtyre detyrimeve sjellë deri tek kontesti midis di palëve, ku pal në këtë procedurë kemi personat juridik.

Procedura kontestimore paraqet metodën e përgjithshme, të rregullt dhe themelore për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile të shkelura apo rrezikuara nga ana e organeve gjyqësore. Ligji për procedurën kontestimore paraqet burimin kryesor të së drejtës procedurale kontestimore.

Sa i përket rregullimit të kontesteve tregtare vlen Ligji i procedurës kontestimore nëse ligji nuk e parasheh ndryshe.

Pra në këtë punim do të flitete për zgjidhjen e kontesteve tregtare, para gjykatës së shkallës së parë, para gjykatës së shkallës së dytë, dhe para gjykatës së shkallës së tretë.

Zgjedhja e kontesteve tregtare gjithashtu mund të inicohet me Procedurën e ndërjetësimit, Procedurën me urdhërpagesë, dhe me padi e iniciar nga vet paditësi, ku në këtë punim është cekur zhvillimi i të tre procedurave të përmendura me lartë.

Në punim janë analizar disa raste nga Gjykata themelore e Gostivarit në periudhen kohore nga viti 2015 deri në vitin 2022.

Përmes këtyre analizave vimë në përfundim se kontestet tregtare mund të zgjidhen në mënyra të ndryshme dike fillaur me marveshje nga vet palët, me ndërmjetësim nese nuk arrihet marveshje ather procedura fillon në rrugë gjyqësore,

KREU I

NË PËRGJITHËSI MBI KONTESTET TREGATRE

1. Kuptimi i kontesteve tregatre

Rendi juridik i një shteti bazohet në lidhjen e fuqishme në mes normave të veta juridike dhe sjelljes reale të njerëzve sipas atyre normave. Rendi juridik fillon me krijimin normave juridike dhe përfundon me relaizimin e tyre nëpërmjet sjelljeve të njerëzve në mardhëniet juridike. Uniteti i këtill i elementit normativ dhe atij faktik egziston edhe në rendin juridiko civil, si pjesë e tërësis së rendit juridik. Rendin juridik e përbëjnë normat juridike me të cilat rregullohen të drejtat subjektive civile dhe mardhëniet juridiko civile si dhe pozita e atyre subjekteve në mardhënie.¹

Subjektet e së drejtës gati se çdo ditë hynë në mardhënie të ndryshme juridiko-civile. Nga këto mardhënie, për subjektet e së drejtës, lindin autorizime të caktuara (të drejta subjektive) ose detyrime (obligime) të caktuara. E drejta subjektive është autorizim juridik i sjellje të caktuar të subjektit të së drejtës, me qëllim të mbrojtjes së interesit të tijë.

Përmbajtja e detyrimit juridik përbëhet nga sjellje të caktuara (bërje mos bërje), e cila shprehet si urdhër ndaj subjektit të detyrimit, që të sillet në mënyrë të caktuar, për arritjen e qëllimit të caktuar. Bartësi i të drejtës subjektive është i autorizuar që të kërkoj nga subjekti i detyrimit juridik përmbushjen e obligimit nga mardhënie e caktuar juridike.

Në të shumtën e rastëve bartësi i detyrimit në mënyrë vullnetare dhe spontane e përmbush obligimin e vet e më këtë njëheri e realizon të drejtën subjektive të bartësit të autorizimit. Në raste të këtilla, në mënyrë spontane dhe vullnetare vjen deri te jetësimi i rendit juridiko-civil në mardhëniet faktike të subjekteve juridike. Megjithatë jo çdo her subjektet e së drejtës sillen në pajtutshmëri me autorizime dhe detyrimet e tyre. Në rastë të caktuar subjektet e së drejtës sillen në mënyrë të kundër me atë që është përcaktuar me norma juridike.

Kjo sjell deri tek cenimi, kontestimi apo shkelja e të drejtave subjektive, respektivisht vjen deri tek tentimi që bartësi i detyrimit të lirohet nga obligimi. Situatat e tilla bëjnë të pashmangshme nevojën që të sigurohet realizimi i dhunshëm i normave juridike, thelbin e të cilit e përbën e drejta në mbrojtje juridike të të drejtave subjektive të përcaktuara me normat juridike-materiale. E drejta në mbrojtje juridike paraqet autorizim të titullarit të së drejtës të kërkojë nga shteti që me aparatit e tij të dhunës të intervenojë me qëllim të mbrojtjes të së drejtës së tij².

¹ DR Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f.1

² Janevski, A Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f.2

Përmes mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, shteti siguron mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave subjektive të cilat nuk janë realizuar në mënyrë spontane nga subjektet e së drejtës. Shteti është i obliguar të siguroj mbrojtjen e të gjitha të drejtave subjektive të njohura, dhe për të gjitha subjektet. Mbrojtja e të drejtave subjektive civile të shkelura, kontestuar apo rrezikuara, realizohet përmes metodës së veçantë të mbrojtjes juridike të të drejtave subjektive civile – procedurës civile.

Kontestet tregtare janë ato konteste që paraqiten midis di personave juridik te vendit dhe te huaj, egzistojn lloje të ndryshme të kontesteve tregtare duke filluar nga : kontestet midis shoqërive tregtare, kontestet në lidhje me falimentimit, konteste në lidhje me pasurit e palujtshme të shoqërive tregtare, kontestet lidhur me pengimin e posedimit midis shoqërive tregtare dhe shum lloje te konetsteve te tjera tregatre. Sa i përket ksaj procedure vlejn rregulla të veçanta, në këtë procedurë tëdija palët mund të vendosim për htyerjen e senacës me qëllim që të arrihet marveshje, për këtë procedurë vlejn rregula të vecanta sa i përket afateve, të cilat janë më të shkurtra se procedura kontestimore.

Për dallim nga porcedura kontestimore palet në procedurë e kontesteve tregatre nuk mund të japin deklarate me gojë në proces verbal para gjykatës,kjo do të thotë se në këtë procedurë dominon parimi me shkrim.

Procedura në kontestet tregtatre mund të inicohet në tre mënyra edhe ato:

Procedurës së ndërmjetësimit

Procedurës së urdhërpagesës

Procedura me inicimin me padi

2.Mënyrat e zgjidhjes së kontesteve

Mënyra e zgjedhjes së kontesteve, e veçanarisht të kontesteve tregtare jnaë të shumta dhe të llojllojshme. Vet natyra e mardhënieve tregtare e cila bazohet në njërin nga parimet themelore, autonominë e vullnetit të lirë të palëve, ka sjellur deri tek ajo që të egzistojnë numër më i madhë i mënyrave të zgjidhjes së këtyre kontesteve.

Kështu veçojmë: zgjedhjen e kontesteve në rrugë paqësore, me metodat diplomatike, me pajtim,zgjidhjen e kontesteve nga gjykata e rregullt shtërore nga gjykata mbi shtetërore institucionale me karakter regjional ose universal, zgjedhen e kontesteve përmes organve joshtetërore-mënyrave alternative të zgjidhjes së kontsteve si nërmjetësim.³

³ Shimac, S. "Mirenje-Alternativni način rjeshavanja sporova", Zagreb, Informator nr. 5404, 2005, f.13

3.PALËT (SUBJEKTET) NE KONTESTET TREGTARE

Me kuptimin e subjektit në drejtësi kuptojmë mundësin dhe të drejtën e një subjekti të jetë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Në procedurën kontestimore si metodë themelore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat subjektive civile të shkelura ose rrezikuara marrin pjesë shumë subjekte të ndryshme ⁴.

Për përcaktimin e tyre shfrytëzohet nocioni i përgjithshëm pjesëmarrës në procedurën kontestimore. Kontesti juridiko - civil lind midis dy personave. Cilësinë e palëve në gjykim ata e fitojnë në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë. Procesi kontestimor paraqet raport juridiko - procedural trepalësh: gjykatës dhe palëve. Për ekzistimin, krijimin e procesit kontestimor janë të nevojshme tri subjekte:

- Paditësi (me padinë e tij e cakton palën e paditur);
- I padituri dhe
- Gjykata - nemo index sine actore – nuk ka gjyqtar pa paditës.

Palët procedurale që janë paditësi, i padituri dhe gjykata janë subjektet pjesëmarrësit kryesor (primar) në procedurën kontestimore. Këto subjekte ndryshe mund të quhen edhe si subjekte procedurale ose subjekte në kuptimin e ngushtë. Vetëm këto subjekte kryejnë veprime procedurale të cilat e përbëjnë thelbin kryesor të procedurës kontestimore.

Përveç, subjekteve të cekur në procedurën kontestimore marrin pjesë edhe disa subjekte të tjera të cilat janë: **përfaqësuesit e palëve, ndërhyrësit, ekspertët, dëshmitarët, procesmbajtësi, interpretuesi, përkthyesit, dërguesit e shkresave** etj⁵. Qëllimi për shkak të të cilit marrin pjesë në procedurë ato është i ndryshëm për atë shkak ato kanë edhe rol të ndryshëm procedural dhe pozitë të ndryshme procedurale. Këto subjekte quhen edhe pjesëmarrës sekondarë të procedurës, por edhe si pjesëmarrës në procedurë kontestimore në kuptim të gjerë.

Subjektet ndihmëse përbëjnë grup në vete, dëshmitarët dhe ekspertët i shërbejnë gjykatës si burim dijenie, kurse interpretuesi dhe procesmbajtësi i ndihmojnë gjykatës dhe palëve që të kryejnë veprime procedurale.

Paditësi - palë e cila e zgjedh palën e paditur i cili duhet që ta shënojë në padinë e tij palën e paditur për kontestin e tyre që nuk mund ta zgjidhin dhe pastaj këtë padi paditësi duhet dorëzuar në gjykatë që gjykata të bëjë zgjidhjen e kontestit në mes palëve.

⁴ Dr. Arsen Janevski dhe Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile; E drejta kontestimore, f. 107

⁵ Prof. Dr. Faik Brestovci, E drejta procedurale civile I, f.39

Palët incidentale-Në procedurën kontestimore përvec paditësit dhe të paditurit pozitën e palës procedurale në raste të caktuar mundtë ta fitojnë edhe personat e tretë. Personat e tretë që e fitojnë pozitën e palës në procedurën kontestimore quhen Palët incidentale ose palëet ad hoc.⁶

Përfaqësuesit e palëve-Me përfaqësuesin e palës kuptojmë kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe në llogari të hujë, personi i cili kryen veprimet juridike në emër dhe në llogari të personit tjetër që quhet përfaqësues. Përfaqësimi në procesin kontestimorë kemi atherë kur një person që nuk është palë në gjykim kryen veprime procedurale në emër të palës me efekte të drejtëpërdrejta për palën dhe kundër saj përfaqësimi është i drejtëpërdrejtë, përfaqësimi i tërthortë nuk mundë të kemi në procesin kontestimorë.⁷

Si përfaqësues mund të paraqiten:

Përfaqësuesi ligjor. Sipas rregullit përfaqësuesi ligjor i ka të gjitha autorizimet dhe detyrimet e palës në procedurën kontestimore. Por në raste të caktuara me rregull të vecantë mund të parashihet që përfaqësuesi ligjor duhet të ketë autorizim të vecantë për ndërmarjen e veprimeve individuale kontestimore, të cilat kanë ndikim esencial në rrjedhën dhe fatin e procedurës. Pala e cila nuk ka zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor.⁸ Rastet e tilla janë p.sh. në:

- a) parashtrimin apo tërheqjen e padisë;
- b) pranimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c) lidhjen e ujdisë dhe të tjera.

Përfaqësuesi i përkohshëm. Nëse procedura rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për personin (të paditurin) me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale) nga ana e organit të kujdestarisë do të zgjaste shumë dhe do të mund të prodhonte pasoja të dëmshme për cilëndo palë, LPK ka paraparë mundësinë që gjykata e shkallës së parë t'ia caktojë atij (të paditurit pra) përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në procedurë i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor dhe këto të drejta dhe detyrime i ushtron derisa i padituri apo i autorizuari i tij nuk paraqiten në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin. Gjykata do t'ia caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në rastet të cilat janë të saktësuara me ligj dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë organin kompetentë të kujdestarisë si dhe palët kur një gjë e tillë është e mundshme.⁹

⁶ Dr. Arsen Janevski dhe Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, *E drejta procedurale civile; E drejta kontestimore*, f.153

⁷ Dr. Arsen Janevski dhe Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, *E drejta procedurale civile; E drejta kontestimore*, f. 200

⁸ Ligji për procedurën kontestimore (LPK) "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr 79/2005 neni 72

⁹ LPK neni 77

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve. Përfaqësuesi ligjor sipas rregullës është i autorizuar që në emer të palës të ndërmer të gjitha veprimet në procedur.¹⁰ Në të drejtën tonë nuk është i paraparë detyrimi i palëve që të drejtat e tyre medoemos duhet t'i realizojnë përmes të autorizuarve, të cilët janë persona me kualifikime profesionale – avokatët. Ata munden që vetë ta udhëheqin kontestin gjyqësor, respektivisht në rastet kur janë të paditur, mbrojtjen dhe kundërshtimet t'i paraqesin personalisht apo nëpërmes të të autorizuarve. Kurse ne kontestet që ygjidhen ne bay te ligjit mbi notariatin respektivisht ne noteri nvarsisht nga vlera e kontestit e parapar me ligj medoemos pala duhet te pervaqsohet nga i autoriyuari – avokati.

4.Llojet e kontestve tregatre

Kontestet midis shoqërive tregtare- kontestet që paraqiten në mes të shoqërive tregatre mundë të zgjidhen në mënyra të ndryshme edhe atë nëpërmjet ndërmjetësimit dhe negociatave, nëse ato nuk mundë të merren vesh ather mund ta zgjedhen në rrugë gjyqësore.

Kontestet në lidhje me falimentimin – falimentimi si nocion i së drejtës të shoqërive tregatre mund të definohet si form të ndërprerjes së subjktiviteti juridik të një shoqërie tregtare.

Kontestet në lidhje me falimentimin në RMV janë të rreguluara në bazë të Ligjit për falimentim. Në bazë të këtijë ligji rregullohen qëllimet dhe arsyet për hapjen e procedurës falimentuse, mënyrën e zhvillimit të procedurës falimentuese, pasojat juridike nga hapja e procedurës falimentuese, administrimi dhe të disponuarit me pasurin që hin në masën falimentuese, përmbushja e kreditorëve në procedurën falimentuese, plani falimentues, administrimi personal, lirimi nga obligimi tjera llojet e posaçme të procedurave falimentuese për individ me status tregtar, procedura falimentuese me elemenin e huaj dhe çështje e tjera lidhur me falimentimin.¹¹

Procedura falimentuese mund të hapet vetëm nëse konstatohen se egziston arsya, paftësia për pagesë (jolikuiditeti) paraqet arsyeje të përgjithshme për hapjen e procedurës falimentuese. Do të konstatohen se debitori është i pa aftë për pagesë (jo likuid) nëse nuk mundet ti përmbushë obligimet e tijë të arritura në para në afat prej 45 ditësh nga dita e arritjes. Debitori mundë të propozoj hapjen e procedurës falimentuese nëse drejtëpër seë drejti i paraprin paftësia për pagesë. Mendohet se debitori është i ballafaquar me likuiditet të drejtëperdrejtë parprijës nëse e bën të mundhme pamundsin që ti përmbush obligimet e tije në para në ditën e arritjes së tyre.¹²

Procedura falimentuese ka për qëllim përmbushjen kolektive të kreditorëve të debitorit falimentues përmes likuidimit të pasurisë së debitorit dhe ndarjen e mjeteve të relaizura të kreditorëve ose përmes lidhjes të marveshjes së veçantë për barazimin e kërkesave të përcaktuara

¹⁰ LPK neni 73

¹¹ Ligji për falimentim neni 1 "Gazeta zyrtare" nr 34 22.03.2006

¹² Ligji për falimentimin neni 4

me planin falimentus që është i orjntuar në ruajtjen e mëtutjeshme të ndrmarrjes afariste të debitorit.

Procedura falimentuese udhhiqet ne rrugë gjyqësore, gjykata kompetente është Gjykta themelore në rajonin e së cilës gjendet selia e debitorit. Procedura falimentuese ngritet vetem nga personi i autorizuar, dhe si procedurë është procedurë urgjente.¹³ vendimet të cilat i sjell gjykatësi falemntues, ndaj tyre nuk lejohet e drejta e Revizionit, si dhe nuk mundë të paraqitet propozim për përsëritjen e procedurës.¹⁴

Organet e procedurës falimentuese jaënen: Gjykatësi falimentues, drejtori falimentues, këshilli i kreditorëve dhe kuvendi i kreditorëve.

Në rase konkrete nuk zhvillohet procedura e falimentimit kur konstatohet se debitori falimentues nuk ka mjete të nevojshem për përmbushjen e harxhimeve procedurale dhe në raste të tilla hapet dhe mbyllet procedura e falimentimit dhe pasi vendimi bëhet i plotfuqishëm debitori falimentues fshihet nga regjistri qendror. Që do të thotë pushon së egzistuari.

Në raste të shumta zhvillohet procedura e falimentimit kur konstatohet se debitori falimentues ka pasuri për përmbushjen e shpenzimeve procedurale si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve nga masa e falimentimit me shëndrimin maës falimentuese në të holla dhe së pari bëhet mbulimi i shpenzimeve të procedurës falimentuese dhe pastaj përmbushja e detyrimeve ndaj kreditorëve në bazë të rangimit duke fillur nga rendi i parë, pasi bëhet shperndarja e pasurisë gjykatësi falemntues bje vendim për mbylljen e procedurës së falimentimit dhe pas plotfuqishmerisë së vendimit bëhet fshyerja e debitorit falimentues nga regjistri qendror.

Konteste në lidhje me pasurit e palujtshme të shoqërive tregtare – konestet me pasurin e palujtshme mund të paraqiten tek personat fizik por mundë të ndodhë që të paraqiten edhe tek shoqërit tregtare¹⁵. Shoqëritë tregtare na paraqiten si person juridik ku hasin konteste ne pasurin e palujtshme kto konteste mundë të zgjidhen në disa mënyra, si mënyrë e par dhe me e sigurt mund të jetë me marvshje te palëve, pra palët me vullnetin e tyre të lirl zgjedhin konestin e tyre, mund të zgjidhen edhe nëprmejt procedurës së ndërmjetësimit, nëse kto lloje zgjidhjesh nuk arrin qllimin e zghjedhjes së konesttit ather fillon të zgjidhet me rrugë gjyqësore.

Procedura fillon me dorzimin ne padisë në gjykatë kur njëra nga shoqëritë tregtare kërkon që ti njihet e drejta e pronsisë së një palujtshmërie të cilën ai e posedon, ku sipas ligjit pronari i palujtshmërie ka të drejtë që palujtshmërin e tij ta ruaj ta shfritzoj dhe të disponoj me të, vetem nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj.

¹³ Ligji për falimentin neni 7

¹⁴ Ligji për falimentin neni 13

¹⁵ Ligji për pronsi dhe të drejtat tjera sendore "Gazeta zyrtare e RMV-se nr 18/2001 neni 2

Kontestet lidhur me pengimin e posedimit midis shoqërive tregtare- kontestet të cilat mundë të paraqiten në lidhur me pengimin e posedimit midis shoqërive tregtare rregullohen në rrugë gjyqësore. Kjo procedurë është me e shpejt, gjykata çdo her do ti kushtoj kujdes të veçantë nevojës së zgjidhjes urgjente sipas natyrës të secilit rast veç e veç. Kjo procedurë inicohet na vet personi juridik me të cilit i pengohet posedimi dher inicohet me padia, përgjgja në padia duhet të jepet në afat prej 8 ditësh. Kjo procedurë para gjykatë të shkallës së parë duhet të mbaroj në afat prej gjashtë muajsh nga dita e paraqitjes së padisë, gjykata e shkallës së dytë duhet të marr vendimin në afat prej 30 ditësh nga paraqitja e ankesës.

KREU II

NË PËRGJITHËSI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

1.Kuptimi i procedurës konestimore

Procedura kontestimore është rrugë apo metodë që ndjekim kur kryejm një punë ajo ka një prejardhje latine që ka kuptimin e ecjës përpara.

Proceduren si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e një gjykimi në çështjen civile, kur themi procedurë civile nënkuptojmë procedurën në kuptimin material si aktivitet i përbërë nga një seri veprimesh konkrete të subjekteve të ndryshme, prania e të cilëve është e domosdoshme në mbrojtjen gjyqësore, apo për realizimin e të drejtës subjektive të shkelur.

Procedura në kuptimin formal i përcakton pjesëmarrësit, të drejtat dhe detyrimet, format dhe afatet e veprimeve në procesin civil si dhe efektet që i prodhojnë në gjykim veprimet e tilla,veprimet procedurale duke përfshirë edhe vendimet e gjykatës janë të lidhura ngushtë me nocionin drejta subjektive e paditësit dhe mu për këtë edhe quhet procedura e vërtetimit tëvendosjës,kognicionit procedura gjyqësore civile si qëllim ka zbatimin e të drejtës materiale mbi situatën konkrete jetësore të natyrës materialo-juridike me ç’rast ka lindur nevoja juridike të vihet në veprim aparati gjyqësor,titullari i të drejtës subjektive duhet vetë ta kërkoj të drejtën e tij nga gjykata për mbrojtje apo realizimin të së drejtës së tijedhe pse gjatë shyrtimeit së procesit gjyqësor civil arrihet jo vetëm mbrojtja apo realizimi i të drejtës subjektive por në të njejtën kohë arrihet edhe mbrojtja e të drejtës objektive ku mund të themi se e drejta subjektive dhe e drejta objektive në esencë janë një dukuri e vetme juridike.

Kontesti-Mosmarrëveshjet apo kontestet ekzistojnë midis dy palëve.

Me kontest duhet të kuptuar se një person fizik apo juridik pretendon se i takon një e drejt kurse pala tjetër e mohon ose e kundërshton detyrimin e tij apo saj. Ku pala e parë që pretendon se i takon ose iu është shkelur një e drejt iu referohet organit kompetent. Kontesti dhe procesi kontestimor kanë dallime të mëdha mesvete, kontesti siç e cekëm më lartë ka kuptimin e mosmarrëveshjes mes palëve me gjendjen e krijuar në raportin materialo juridik kurse procesi kontestimor është procesi të cilin ndjekin gjykatatat për të zgjidhur çështjet e kësaj natyre.

1.1.Procedura para gjyktës së shkallës së parë

Kuptimi i padisë- Padia është veprimi i parë procedural me të cilën vihet në veprim procesi kontestimor.

Ngritja e padisë- Procedimi civil vihet në lëvizje me parashtrimin e padisë si akt hyrës (fillestar) procedural, në të cilin theksohet një kërkesë e caktuar pa marrë parasysh se si kuptohet ai termin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.

Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e padisë, e cila është veprim procedural i palës me të cilin kërkohen mbrojtja gjyqësore më anë të vendimit të gjykatës. Procedimi civil vihet në lëvizje me parashtrimin e padisë si akt hyrës (fillestar) procedural, në të cilin theksohet një kërkesë e caktuar pa marrë parasysh se si kuptohet ai termin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.¹⁶

Padia trajtohet në dy aspekte: në aspektin material dhe formal të padisë. Padia në aspektin material përbën kërkesën e paditësit që gjykata me vendim të përmbajtjes së caktuar ta detyroj të paditurin për kryerjen e prestimit në dobi të tij, ose të konstatoj se ekziston apo nuk ekziston raporti materialo-juridik i caktuar, ose të ndryshoj një situatë juridike.

Padia në aspektin formal është vetë parashtrësja. Padia, përgjigjja në padi, mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat tjera, propozimet dhe njoftimet, që bëhen jashtë seancave gjyqësore, paraqiten me shkrim (parashtrësja)...”. Thënë thjeshtë, padia në kuptimin formal është parashtrësja.

Përmbajtja e padisë.

Padia pavarësisht nga lloji i saj duhet të përmbajë:

- kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- vlerën e kontestit;
- bazën juridike dhe
- të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësja.¹⁷

¹⁶ Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009, fq.17

¹⁷ LPK neni 98 dhe neni 176

Kërkesëpapia - (Petitumi)- Me anë të kërkesëpadi së paditësi e formulon mendimin se si duhet të duket dispozitivi i aktgjykimit me të cilin pranohet ajo.

Pra, kërkesëpapia duhet t'i përgjigjet tekstualisht vendimit të dëshiruar, sepse varësisht nga kjo do të nxirret kërkesëpapia edhe vendimi i gjykatës, natyrisht nëse padia është e lejueshme dhe e themeltë. Padia duhet ta përmbaj gjithmonë kërkesën e përcaktuar lidhur me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore.

Është më rëndësi që paditësi ta saktësoj kërkesën e padisë, sepse gjykata është e detyruar që të kufizohet brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse dhe në këtë kuptim, pas përfundimit të procesit gjyqësor, me vendim meritator të vendos nëse kërkesëpapia është e themeltë. Praktikisht, është e nevojshme që kërkesëpapia të saktësohet në pikëpamje objektive (të caktohet objekti i kontestit), në pikëpamje subjektive (të përcaktohet se kush janë palët në kontest) dhe në pikëpamje të sasisë/vëllimit të se drejtës subjektive për mbrojtjen e të cilës është paraqitur padia.

Propozimi i padisë (petitumi), është propozimi se si duhet të jetë dispozitivi i aktgjykimit sipas mendimit të paditësit, mirëpo gjykata mund ta strukturoj ndryshe dispozitivin e aktgjykimit pavarësisht nga propozimi i paditësit, por gjithmonë duke e ruajtur me saktësi përmbajtjen e propozimit

Kërkesëpapia e caktuar është e nevojshme edhe për faktin e sigurimit të kufizimit të qartë të objektit të efektit të vendimit të formës në kuptimin material. Pra, të dihet qartë në rast të nxjerrjes së vendimit, se cila çështje është zgjidhur dhe se tanimë ajo çështje e zgjidhur është e formës se prerë, si në kuptimin formal ashtu edhe në kuptimin material.

Objekti i kontestit- Objekt i kontestit është çështja në lidhje me të cilën ekziston mosmarrëveshja (kontesti) midis paditësit dhe të paditurit. Objekti i padisë është ajo që kërkohet si efekt i padisë d.m.th. zbatimi i ligjit dhe realizimi i së drejtës së shkelur, p.sh. kthimi i sendit, pagimi i qirasë, apo pronësia mbi sendin.

Nga kjo rrjedhë se, objekti i padisë duhet dalluar nga objekti material (sendi) që është objekt i së drejtës. p.sh., për një objekt material (send) mund të paraqiten disa lloje padish, sikur, padia për kthimin e sendit, padia për pronësinë e sendit, për kompensimin e shfrytëzimit të sendit etj.

Baza juridike - Bazën juridike të kërkesëpadi së e përbën kualifikimi juridik i fakteve, në të cilat paditësi e mbështetet kërkesëpadinë. Të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë. Të dhënat tjera që duhet t'i përmbaj padia sikurse çdo parashtrësë, janë të dhënat mbi:

Emrin e gjykatës (përfshi edhe departamentin përkatës, përveç kur padia dorëzohet në degën e ndonjë gjykatë me ç 'rast në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore),

- Emrin dhe mbiemrin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik,

- Vendbanimin apo vendqëndrimin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik (selinë e personit juridik) palëve,

-përfaqësuesi ligjor apo me prokurë, (në qoftë se palët kanë përfaqësues),

- Objektin e kontestit,

- vlera e kontestit

- Përmbajtjen e deklaratës dhe

- Firmën e parashtruesit

Taksa gjyqësore - Për padi Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Ligjdhënësi detyrimit të paditësit për pagesën e taksës gjyqësore i ka dhënë cilësinë e prezumimit procedural (kusht nga i cili varet lejueshmëria e procesit gjyqësor) në atë mënyrë që nga fakti nëse është paguar taksa gjyqësore për padi do të varet vazhdimi i mëtejme i zhvillimit të procesit gjyqësor.

2.Përgaditja e shqyrtimit kryesor

Shqyrtimi kryesor paraqet fazën kryesore dhe më të rëndësishme në procedurën kontestimore. Në këtë fazë të procedurës bëhet finalizimi i veprimeve procedurale të palëve, gjykatës dhe përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë me sjelljen e vendimit lidhur me çështjen e iniciuar me padi. Që shqyrtimi kryesor të përfundojë me sukses, pa zvarritje dhe sa më me pak shpenzime është e nevojshme që ai të përgatitet mirë.

2.1.Faza përgatitore e shqyrtimit kryesor

Zhvillimi i kësaj fazë është i detyrueshëm për gjykatën e cila fillon që nga momenti i ngritjes së padisë dhe zgjat deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor. Përgatitja e shqyrtimit kryesor kalon nëpër katër faza:

1. Ekzaminimi paraprak i padisë;
2. Dërgimi i padisë palës së paditur për përgjigje në padi
3. Mbajtja e seancës përgatitore dhe
4. Caktimi i seancës për shqyrtim kryesor të çështjes.¹⁸

Me qëllim që çështja e cila është shtruar para gjykatës të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjyqtari i çështjes që nga momenti i marrjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor mund të merr aktvendime dhe të vendos për:

- a) dhënien e përgjigjes në padi nga pala e paditur;
- b) sigurimin e proves
- c) tërheqjen e padisë;
- d) ndryshimin e padisë;
- e) ndërprerjen e procedurës;
- f) pjesëmarrjen e ndërhyrësit;
- g) hyrjen e paraardhësit juridik në procesin gjyqësor;
- h) veçimin apo bashkimin e dy proceseve gjyqësore;
- i) caktimin apo zgjatjen e afateve gjyqësore;
- j) caktimin apo shtytjen e seancave;
- k) rivendosjen në gjendjen e mëparshme;

¹⁸ LPK neni 262 parag 1,2,3

- l) masat e përkohshme të sigurimit;
- m) sigurimin e shpenzimeve procedurale;
- n) lirim të palës nga pagimi i shpenzimeve procedurale;
- o) deponimin e paradhënies për shpenzimet e veprimeve procedurale;
- p) caktimin e ekspertit;
- q) emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm;
- s) masat për përmirësimin dhe plotësimin e parashtresave;
- t) rregullsinë e përfaqësimit dhe të prokurës;
- u) mos kompetencën e gjykatës;
- v) bashkimin e padive;

x) pushimin e gjykimit kur hedhet poshtë padia apo kur tërhiqet ajo, si dhe të gjitha çështjeve tjera që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit.

Kundër aktvendimeve të dhëna gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit nuk lejohet ankimi.

Në këtë fazë të procedurës i është dhënë mundësia gjyqtarit të çështjes që të merr aktgjykim në bazë të pohimit, aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, aktgjykim për mos bindje, aktgjykim për shkak të mungesës si dhe të miratojë ujdinë gjyqësore të palëve.¹⁹

2.2.Egzaminimi paraprak i padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë është fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesorë të cilën e bën gjyqtari i çështjes. Këtë aktivitet procedural gjyqtari e kryen pasi që të paraqesëpadinë paditësit. Gjyqtari i shqyrtimit paraprak të padisë e bën duke e vërtetuar se a janë plotësuar prezumimet procedurale në mënyrë që mundë të procedohet sipas padisë.²⁰

Në bazë të materialit që e ka në disponim, gjyqtari i çështjes mund të konstatoj se ekzistojnë pengesa procedurale të cilat mund të evitohen.

Si pengesa procedurale të cilat mund të evitohen, në ligj përmenden:

- ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë

¹⁹ LPK neni 263 paragraf 1,2

²⁰ LPK neni 265

- padia është e pakuptueshme apo jo e plotë;
- mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kurndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre; autorizimi i tillë kërkohet me ligj.²¹

Hedhja e padisë si e palejueshme-Pa shqyrtimit paraprak të padisë, gjyqëtari i çështjes ma aktvendim e hedh posh padinë nëse konstaton se zgjedhja e kërkesë padisë nuk bën pjesë në kompetencën gjyqësore ose se padia nuk është paraqitur në kohë nëse me rregullat e vecanta është përcaktuar afati për paraqitjen e padisë.²²

Shpallja jokompetente e gjykatës- Ekzistimi i kompetencës territoriale dhe i asaj lëndore për zgjidhjen e çështjes konkrete paraqet prezumim procedural, për të cilën gjyqtari i çështjes sipas detyrës zyrtare duhet të kujdeset gjatë gjithë procedurës.²³

Në këtë fazë të procedurës, pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjyqtari i çështjes merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpall jokompetente dhe lëndën ia dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për shqyrtimin e çështjes së ngritur me padi, nëse konstaton:

1. se nuk është e kompetencës territoriale për gjykimin e çështjes;
2. se nuk është e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.²⁴

2.3.Përgjigja në padi

Kur pas shqyrtimit paraprak të padisë gjyqëtari i çështjes vleron se padia është e rregullt dhe e plotë, atëherë me aktvendim padinë së bashku me shkresat e lëndës do t'ja dërgoj të paditurit për përgjigje në padi mrenda 15 ditësh nga dita kur padia është paraqitur në gjykatë. I padituri, pasi të dërzohet padia me shkresat e bashkangjitura eventualisht, ka për detyrë që mbrenda afatit prej 15 ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi²⁵

Udhëzimet e gjykatës për të paditurin me rastin e dërgimit të padisë për përgjigje -Në vazhdim janë paraqitur udhëzimet e gjykatës në aktvendim për dorëzimin e padisë në përgjigje, për përmbajtjen që duhet të ketë përgjigja në padi si dhe për pasojat procedurale për mos respektim të afatit

- ✓ I padituri është i detyruar që në përgjigje në padi t'i paraqet prapësimet procedurale dhe të për përgjigje në padi. deklarohet se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftë se i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditësit, përgjigja në padi duhet t'i

²¹ LPK neni 75 dhe 266

²² LPK neni 276

²³ LPK neni 15

²⁴ LPK neni 276 parag 2

²⁵ LPK neni 269 parag 1

përmbaj faktet mbi të cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me të cilat pranohen faktet e paraqitura.

- ✓ Në qoftë se, përgjigja në padi është e pakuptueshme apo e jo e plotë, me qëllim të eliminimit të t'i përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozita nga neni 99, i LPK-së.
- ✓ Paralajmërohet i padituri se, në qoftë se brenda afatit të caktuar nuk e paraqet përgjigjen në padi, atëherë gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë-mosbindjes, po që se plotësohen kushtet.
- ✓ Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t'ia paraqes autorizimin në rregull.²⁶

Vendimet të cilat mund të jepen pas përgjigjes në padi -Kur gjyqtari i çështjes pasi t'i arrijë përgjigja në padi, vleron se ndërmjet palëve nuk është kontestuese, gjendja faktike, dhe se nuk egzistojnë pengesa të tjera për dhenien e vendimit meritor, atëherë pa caktuar fare senacë gjyqësore mundë të jap aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.²⁷

2.4.Mbajtja e seancës përgatitore

Me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e paraparë se procedura e shkallës së parë, si rregull nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj.

Përbëhet prej dy senacave gjyqësore:

- a) Sencëa përgatitore
- b) Seancës për shqyrtimin kryesorë të çështjes

Kështu tani mbajtja e seancës përgatitore, në parim, paraqitet të jetë e detyrueshme, përveç rasteve në të cilat gjykata pasi që t'i ketë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese, apo kur nga shkak i pa ndërlikueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë që të mbahet seanca përgatitore.

Format e mbajtjes së seancës përgatitore- Sipas disa teoricienëve, seanca përgatitore mund të zhvillohet në forma të ndryshme, si p.sh., në formë të takimit në gjykatë, sqarimeve përmes telefonit, sqarimeve me shkrim, apo gojarisht, në ndonjë mënyrë tjetër. Sidoqoftë, është gjykata ajo e cila do të përcaktojë se në cilën formë do të realizohet kjo seancë, ndërsa që praktika gjyqësore e sistemit tonë juridik ka dëshmuar se seanca përgatitore zhvillohet në formë

²⁶ LPK neni 269 parag 2

²⁷ LPK neni 270 parag 3

të takimit në gjykatë, me ç'rast edhe zgjidhen një mori çështjesh të caktuara të cilat duhet të trajtohen në këtë séance.

Caktimi dhe mbajtja e seancës përgatitore- Gjykata e cakton seancën përgatitore, pasi që të arrijë përgjigja në padi e të paditurit. E nëse i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, gjykata do ta konvokojë seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes me shkrim në padi. Si rregull, seanca përgatitore duhet të mbahet më së voni brenda afatit 50 ditor nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja me shkrim e të paditurit.

Në letërthirrjen për në seancën përgatitore, gjykata duhet t'i njoftoj palët për pasojat e mosardhjes në seancë, si dhe për detyrën e tyre që më së voni deri në përfundim të kësaj seance, ata duhet t'i parashtrorjnë gjykatës:

- a) të gjitha faktet në të cilat i mbështesin kërkesat e tyre;
- b) t'i propozojnë të gjitha provat që dëshirojnë të merren gjatë procedurës,
- c) por që edhe në këtë seancë t'i sjellin të gjitha shkresat dhe sendet që dëshirojnë t'i përdorin si mjete provuese.

Andaj del se seanca përgatitore është faza e fundit deri kur palët mund:

- a) t'i theksojnë faktet e reja dhe t'i propozojnë provat e reja;
- b) ta ndryshojnë kërkesëpadinë;
- c) të ushtrojnë kundërpadi, apo
- d) që paditësi i ri të bashkëngjitet në kontest ose që padia të zgjerohet edhe në të paditur të tjerë.

Gjithashtu edhe gjykata, më së largu deri në përfundimin e seancës përgatitore, mund të vendos që:

- a. t'i bashkojë disa konteste për procedim të përbashkët, apo
- b. që të bëjë ndarjen për shqyrtim të veçantë të ndonjë kërkesë të një padie unike

Letërthitja e palëve duhet tu dërgohet së paku 8 ditë para ditës në të cilën mbahet ajo.²⁸

Senca përgatitore fillon me shtjellimin e padisë nga ana e paditësit e pastaj edhe me shjellimin e përgjigjes në padi të parashtruar nga ana e të paditurit.

²⁸ LPK neni 272 parag 1

Varësisht nga rezultati i shqyrtimit në seancën përgatitore, gjykata do të vendos se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Kësisoj propozimet të cilat nuk i konsideron esenciale për dhënien e vendimit meritore, përmes aktvendimit kundër të cilit nuk lejohet ankimi i veçantë, gjykata i refuzon, njëherësh duke i treguar edhe shkaqet e refuzimit.

Nëse gjykata me propozimin e palës, vendos që të merret prova me anë të ekspertimit, atëherë ajo e cakton edhe afatin brenda të cilit eksperti me shkrim duhet ta paraqesë konstatimin dhe mendimin e vet.²⁹

2.5.Caktimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes

Në fakt, caktimi apo konvokimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, paraqet fazën e fundit të personat që do të thirren në seancën kryesore . Në këtë rast gjykata me aktvendim e cakton seancën

- provat që do të merren në seancën
- çështjet që do të shqzrtohen dhe bisedohen në seancën kryesore
- ditën dhe orën e mbajtjes së seancës për shqzrtimin kryesorë të çështjes
- personat që do të thiren në seancën përgaditore

Në këte rastë palët prezente në seancën përgaditore njoftohen drejtpërdrejtë me përmbajtjen e këtijë aktvendimi dhe atyre nuk do tu dërgohet as aktvendimi as letëthyryja për seancën e shqyrtimit kryesorë.

Rrjedhimisht i bie se ndaj këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë. Në po këtë seancë, gjykata do t'i njoftojë palët e pranishme edhe për pasojat procedurale të mos ardhjes në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Për seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, me letërthirje do të ftohen palët të cilat nuk kanë qenë të pranishme në seancën përgatitore, dëshmitarët si dhe ekspertët të cilët duhet të paraqiten sipas vendimit të gjykatës për marrjen e provave përkatëse përmes tyre.

Edhe në këte rast gjykata përmes letërthytjes për seancat kryesore duhet ti paralajmëroj palët për pasojat e mos ardhjes në seancë.pala që nuk ka qenë e pranishme në seancë e shqyrtimit përgaditore bashkë me letërthirjen për seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes duhet ti dërgohet edhe kopja e verifikuar e procesverbalit nga seanca përgaditore.

²⁹ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f.358

Në parim, seanca kryesore do të mbahet më së voni brenda afatit prej 30 ditëve nga dita kur është mbyllur - përfunduar seanca përgatitore. Në këtë mënyrë brenda këtij afati, i cili paraqitet të jetë i mjaftueshëm, gjykata por edhe palët do të mund të përgatiten për seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes.

Zakonisht gjykata do të mund të vendoste që seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore, nëse nga shqyrtimi i seancës përgatitore del se:

1. Ndonjëra nga palët nuk ka legjitimicion aktiv apo pasiv në çështjen kontestimore
2. Egyiston parashkrimi i kërkesës, me kushtë që pala të jetë e thirur në të
3. Faktet vendimtare për vendosjen e çështjes janë jokontestues në mes të palëve

2.6.Shqyrtimi kryesor

Ligji për Procedurën Kontestimore (“ligji”) rregullon zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhëniet civile juridike. Gjyqtarët e kanë për detyrë që procedurën ta zhvillojnë pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe ta bëjnë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale (me fjalë tjera, të sigurojnë respektimin e rregullave të procedurës).

Në fakt, ligji u kërkon gjyqtarëve që të fillojnë përgatitjet për shqyrtim menjëherë pasi të arrijë padia e paditësit në gjykatë.³⁰

Pozicionimi i lëndës në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Nëse gjyqtari e ndjek radhën e veprimeve të përcaktuara me Ligjin për Procedurën Kontestimore përkitazi me fazën përgatitore të procedurës, lënda do të jetë në pozitë të mirë ndërkohë deri sa të fillojë shqyrtimi kryesor i çështjes.

Për ta thjeshtësuar, gjyqtari do të jetë në pozitë të parashikojë se cilat prova do të paraqiten si relevante gjatë shqyrtimit kryesor dhe do të jetë i njoftuar (dhe i përgatitur për zgjidhje) për pengesat potenciale që janë identifikuar në fazën përgatitore të gjykimit. Për shembull, gjyqtari do të ketë kryer këto veprime organizative:

- Elementet ligjore (baza juridike) e padisë së suksesshme
- Konstatimi për faktet e ditura botërisht dhe faktet e vërtetuara nga gjykata në gjykimet e mëhershme
- Faktet materiale të pa kontestuara
- Çështjet relevante për gjykim

³⁰ LPK neni 262

- Deklaratat e dëshmitarëve
- Mendimi i ekspertit
- Provat shkresore
- Prova e siguruar
- Këqyrja në vend

Konvokimi i seancës për shqyrtim kryesor të çështjen

Gjyqtari i çështjes seancën për shqyrtim kryesor të çështjes e konvokon me aktvendim, të cilin e jep në fund të seancës përgatitore, përkatësisht para përfundimit të saj.

Model i aktvendimit për konvokim të seancës për shqyrtim kryesor

<p>Seanca për shqyrtim kryesor të çështjes ...</p> <p>Koha e mbajtjes së seancës Dita dhe ora:</p> <p>Përshkrimi i objektit të shqyrtimit kryesor</p> <p>Çështjet të cilat konsiderohen relevante për vendosjen e çështjes kontestuese</p> <p>Provat të cilat do të nxirren në seancën e shqyrtimit kryesor</p> <p>Personat të cilët duhet të thirren në seancën e shqyrtimit kryesor. ³¹</p>
--

Gjyqtari në seancë përgatitore, varësisht nga rezultati i shqyrtimit, do të nxjerrë përfundim se për çfarë do të bisedohet gjatë shqyrtimit kryesor dhe cilat prova do të nxirren në seancën për shqyrtim kryesor . Krejt ajo çka përmban aktvendimi mbi konvokimin e seancës kryesore palët që kanë qenë të pranishme në seancë përgatitore janë njoftuara nga diktimi me zë në procesverbal të seancës përgatitore apo me leximin e tij para se ta nënshkruajnë.

Palëve që kanë qenë të pranishme në seancën përgatitore nuk ka nevojë që t'u dërgohet aktvendimi për konvokimin e seancës kryesore e as thirrje për seancë. Për seancë kryesore thirren palët të cilat nuk kanë marrë pjesë në seancën përgatitore, si dhe ekspertet dhe dëshmitarët të cilët duhet të paraqiten në gjykatë sipas aktvendimit për marrjen e provës e të cilët janë parapa në aktvendimin për konvokimin e seancës kryesore.

Palët të cilat nuk kanë qenë të pranishme në seancë përgatitore si dhe personat e tjerë, të cilët është parapa që të thirren për seancë kryesore, gjykata në letërthirrje do ti paralajmëroj për pasojat e mos ardhjes në seancë. Palët e të cilat nuk kanë qenë prezent në seancën përgatitore, bashkë me letërthirrje për seancë kryesore i dërgohet edhe kopja e procesverbalit e verifikuar nga seanca përgatitore në të cilin është përfshi aktvendimi për konvokim të seancës kryesore.

³¹ LPK neni 278

Zhvillimi i shqyrtimit kryesorë - Shqyrtimi kryesorë është faza qendrore e procedurës kontestimore. Atë e bëjnë veprimet procedurale të gjykatës dhe të palëve, të kryera në një apo më tepër seanca, me qëllim të shoshitjes dhe shqyrtimit të fakteve nga të cilat varet themelësia e kërkesëpadisë.

Hapja e seancës për shqyrtim kryesor - Gjyqtari i çështjes e hap seancën dhe e shpall objektin e shqyrtimit, i cili mund të jetë p.sh. kompensimi i dëmit, përmbushja e kontratës, anulimi i kontratës etj

Pasojat juridike të mos paraqitjes së palëve - Kurë paditësi nuk vjen në seancë kryesore, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, konsiderohet se e ka tërhequr padinë. Në këtë rast, nëse pala e paditur nuk propozon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit, gjyqtari i çështjes në procesverbal merr aktvendim me të cilin konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.

Por një veprim i tillë nuk sjellë humbjen e së drejtës së padisë, që do të thotë se paditësi mund të paraqes këtë padi përsëri. Mund të ndodhë që në seancën e shqyrtimit kryesor të mos paraqitet paditësi edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë formë. Në këtë rast gjyqtari mund ta mbaj seancën kryesore në mungesë të paditësit, mirëpo këtë mund ta bëjë vetëm kurë i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të tij³².

Drejtimi i shqyrtimit kryesor - E përbëjnë veprimet procedurale me anë të të cilave gjykata e drejton fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e shqyrtimit kryesorë.

Sipas dispozitave ligjore të LPK-së autorizimet për drejtimin e procedurës në shqyrtim kryesor në aspektin proceduralo-juridik dhe materialo-juridik në shkallë të parë i ka gjyqtari i çështjes.

Gjyqëtari ka për detyrë që të kujdeset që shqyrtimi kryesorë të zhvillohet në mënyrë të rregullt, pa zvarritje dhe pa shterje të nevojshme. Këto qëllime mundë të arrihen atherë kur gjyqëtari i çështjes që në seancën për shqyrtim kryesorë të shqyrtohen vetm çështje të cilat janë me rëndësi për marrjen e vendimit dhe asesi të mos lejoj që palët me shpjegime dhe parashtrime të panevojshme qoft gjatë shpjegimeve të padisë apo paraqitjes së në padi, gjatë dëgjimit të dëshmitarëve apo të palëve ose gjatë paraqitjes së fjalëve përfundimtare të ndikojnë në zvarritjen të procesit dhe zhvillimit normal të kontestit.³³

Mbajtja e rendit - Kryetari kanë për detyrë që të kujdesen për mbajtjen e rendit në shqyrtim kryesor, që paraqet një nga kushtet për zhvillimin normal të procedurës. Mbajtja e rendit konsiston në pengimin e sjellje jo korrekte, të pa dinjitetshme dhe të pahijshme të secilit

³²LPK neni 280

³³ LPK neni 283 parag 1 dhe 2

që merr pjesë në shqyrtimin kryesor si dhe në ruajtjen e dinjitetit të gjykatës dhe pjesëmarrësve në procedurë.³⁴

Në këtë fazë të procedurës gjyqtari i çështjes mund të marrë masa ndaj personave të cilët e shkelin rendin në gjykatë ose cenojnë dinjitetin e gjykatës dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë.

Zhvillimi i procedurës në shqyrtim kryesor - Gjatë shqyrtimit kryesorë veprimet procedurale të palëve dhe të gjykatës ndërmeren gojarisht. Përrjashtimisht kur shqyrtimi kryesorë nuk zhvillohet gojarisht bëhet në raste kur personi i shurdhër opo i verbër, për shkak të këtyre pengesave duhet që pyetjet opo përgjigjet ti parashtrojn në formë të shkruar.

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesorë provat meren drejtëpërdrejtë para gjykatës përkatësisht para gjyqtarit të çështjes. Përrjashtimi nga kjo marje e drejtëpërdrejtë e provave bëhet në rastin kur prova është dashur të meret nga gjykata e porositur apo kur është bërë sigurimi i provës para ngritjs së padisë.³⁵

Në këto raste prova nuk merret drejtëpërdrejt në gjykatë, e cila do të vendos lidhur me objektin e kontestit por para kësaj gjykate do të lexohen procesverbalet për provat e marra para gjykatës tjetër .

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor palët në shpjegimet e veta duhet t'i parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat i mbështesin arsyetimet e propozimeve dhe i propozojnë të gjitha provat me të cilat mendojnë që ti vërtetojnë ato fakte si dhe të deklarohen lidhur me faktet dhe provat e palës tjetër.

Shtyrja dhe vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor - Në situata të caktuara, gjyqtarët mund ta shtyjnë apo vazhdojnë seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes. Por, Ligji për Procedurën Kontestimore kërkon që gjyqtarët të kujdesen që shqyrtimin kryesor ta zhvillojnë në drejtimin e duhur dhe në mënyrë të rregullt, pa shtyrje të panevojshme.

Edhe pala është e kufizuar në mundësitë e saj për ta shtyrë seancën kryesore. Ligji parashikon opsionet si në vijim, për kufizimet e shtyrjes dhe vazhdimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes:

- Shtyrja e seancës gjyqësore për shkak të mosplotësimit të prezumimeve ligjore apo për shkak të mungesës së provave.
- Vazhdimi i seancës për shkak të mungesës së provës.
- Shtyrja e seancës kryesore me kërkesë të palës.
- Shtyrja e seancës kryesor sipas detyrës zyrtare
- Shtyrja e seancës që ka filluar.

³⁴ LPK neni 303

³⁵ LPK neni 297 parag 1

- Përsëritja e veprimeve procedurale të kryera në seancën e re
- Ndalimi i shtyrjes së seancës në kohë të pacaktuar etj

2.7.Përfundimi i shqyrtimit kryesor dhe fjala përfundimtare e palëve

Pasi janë shqyrtuar provat e paraqitura nga palët dhe që gjykata ka pranuar marrjen e tyre, gjykata i ftohen palët për të parashtruar pretendimet e tyre përfundimtare rreth çështjes në gjykim. Në fjalën përfundimtare palët bëjnë vlerësimin e gjithë materialit procedural, e formulojnë kërkesën që gjykata ta jep vendimin përfundimtar dhe arsyetojnë atë në pikëpamje juridike.

Në fjalën përfundimtare palët duhet që vetëm të paraqesin rezyme dhe të nënvizojnë në lidhje me atë që është theksuar gjatë shqyrtimit, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të paraqiten fakte apo propozime të reja dhe ndryshim të kërkesëpadisë.³⁶

Si rregull, fjalën përfundimtare palët e paraqesin gojarisht, por paraqitja në këtë mënyrë nuk përbën detyrim ligjor për palët. Ngase, siç edhe ndodhe në disa raste në praktikë, me kërkesën e palëve, gjykata mund t'u japë atyre një afat (p.sh, 5 ditë) për të paraqitur fjalën përfundimtare në formën e shkruar. Në fjalën përfundimtare të palëve në fillim e merr fjalën paditësi dhe pastaj e padituri. Kur merr pjesë ndërhyrësi kryesor, ai e merr fjalën pas të paditurit.

Ndërsa kur merr pjesë ndërhyrësi në anën e paditësit ai e merr fjalën pas tij. Po kështu vepron edhe të ndërhyrësi në anën e të paditurit. Të gjithë këtyre u është lënë mundësia që shkurtimisht të deklarohen lidhur me fjalën përfundimtare të njëri tjetrit.

Gjuha në procedurë Bazuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikë së Maqedonisë, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.³⁷

³⁶ LPK neni 289

³⁷ Kushtetuta e RMV-SË neni 7

2.8.Shqiptimi i vendimit përfundimtar

Vendimi përfundimtar i një procedure kontestimore mundë të mbaroj me Aktgjykim dhe Aktvendim.

2.8.1.Aktgjykimi

Me aktgjykim gjykata vendos për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur më kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendos për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjukata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendos për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

a.Përmbajta e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë pjesën formale dhe materijale. Përmbajtjen formale e përmbajnë pjesët e aktgjykimit ndërsa pjesën materijale e përmbajnë PËRMBAJTJA e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet aktgjykimi.

b.Përmbajtja formale e aktgjykimit

Pjesa hyrëse

Sipas nenit 327 parag 2 të LPK-së, pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban këto dhjetë (10) lloje të informacioneve:

- emrin e gjykatës
- emrin dhe mbiemrin e gjyqëtarit
- emri i gjykatës
- emri dhe mbiemri, vendbanimi vendqëndrimi i palëve
- identifikimi i përfaqësuesve ligjor apo me prokurë
- përshkrimin e shkurtër të objektit të lëndës dhe vlerën e saj
- ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesore
- përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim
- ditën kur është dhënë aktgjykimi.³⁸

³⁸ LPK neni 327 parag 2

Dispozitivi

Sipas nenit 327.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosegzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.³⁹

Pjesa e arsytimit

Në pajtim me të LPK-në, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, gjykata duhet të përfshijë rezultatet e veprimeve të mëposhtme:

- kërkesat e palëve
- faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët
- specifikimin se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakt
- përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte
- Nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Kualifikimin juridik të veprës dhe dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.⁴⁰

Udhëzimi mbi të drejtën në ankesë- Sipas nenit 160.1 të LPK-së, aktgjykimi duhet të përmbajë udhëzimin mbi të drejtën në ankesë.

Nënshkrimi- Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që aktgjykimin burimor e nënshkruan kryetari i këshillit përkatësisht gjyqëtari individual.⁴¹

³⁹ LPK neni 327 parag 3

⁴⁰ LPK neni 327 parag 4

⁴¹ LPK neni 326 parag 2

2.8.2. Aktvendimi

Është lloj I vendimit të cilën e sjell gjykata në procedurë kontestimore në rast kur ajo nuk vendos me aktgjykim. Sipas rregullës me aktvendim gjykata vendos për çështje procedural, kurse me përjashtim me aktvendim gjykata vendos edhe për meritumin e kontestit, edhe në disa procedura të vecanta kontestimore-procedura për pengimin e posedimit dhe procedura për dhënien e urdhërpagesës.

Aktvendimi me të cilën në procedurë për dhënien e urdhërpagesës pranohet kërkespadija ka formë të urdhërpagesës.

Aktvendimet të cilat I sjell gjykata gjat procedurës mund të grupohen:

- Aktvendime për drejtim të procedurës
- Aktvendime me të cilat venoset për prezumimet procedurale
- Aktvendime me të cilat vendoset për autorizime të palëve
- Aktvendim me të cilat ndalet procedura
- Aktvendime me të cilat vendoset në mënyrë meritore etj.

Aktvendimi sillet pas përfundimit të procedurës kontestimore, të gjitha aktvendimet që sillen në séance I shpall kryetari I këshillit, respektivisht kryetari individual dhe I përfshin në procesverbal.

Për dallim nga aktgjykimi përmbajtja me shkrim të aktgjykimit duhet të përmbajë vetëm hyrjen dhe urdhërin. Aktvendimi duhet të arsyehet vetëm nëse:

- Me anë të tij refuzohet propozimi I palës
- Nëse me anë të tij vendoset për propozime të palëve të cilat ndërmjet veti janë në kundërshtim.

Aktvendimi mund të arsyehet edhe në raste të tjera kur është e nevojshme.

Aktvendimi me të cilën vendoset në mënyrë meritore, përmburon në mënyrë të dhunshme me kërkesë të palës. Aktvendimet e plotfuqishme për dënimet e shqiptuara sipas dispozitave të LPK përmbahen në mënyrë zyrtare.⁴²

⁴² . Arsen Janevski dhe Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile; E drejta kontestimore, f.387-388

II.Procedura sipas mjeteve juridike

1.Mjetet e rregullta të goditjes

Mjet goditjeje me të cilën pala apo personi tjetër i autorizuar nga gjykata kërkon që ta prish apo ndrishoj vendimin për të cilin pretendohet të vërtetohet se është i pavolitshëm i padrejtë dhe i kundërligjshëm.

1.1.Ankesa kundër aktgjykimit

Ankesa është mjet o rregullt juridik i goditjes së vendimit të shkallës së parë. Ankesa është lejuar kundër çdo aktgjykimi të shkallës së parë. E drejta e ankimit është e garantuar me Kuashtetutën e Maqedonisë së Veriut.

Ankesa është e lejuar kundër çdo aktgjykimi të shkallës së parë, pa përjashtim;

a) Efektet e ankesës

Ankesa është mjet me efekt supspenyiv, me paraqitjen e saj pengohet marrja e formës së prerë të aktgjykimit në tërësi apo në pjesën e goditur. Ankesa është mjet devulativ sepse me paraqitjen e saj themelohet kompetenca e gjykatës së shkallës më të lartë që të shqyrtoj vendimin e goditur. Përveç kësaj ankesa është mjet i pavarur për të vendoset paravrsishë mjeteve tjera të goditjes.

b) Interesi juridik për goditjen e vendimit

Sikurse çdo vendim procedural ashtu edhe për mjetin e goditjes është paraparë se pala mund të përdor vetëm në qoft se për një gjë të tillë ka interes juridik . për paraqitjen e mjetit të goditjes pala ka interes në qoft se shpreson se në lidhje me të gjykatata kompetene do të jap vendimin më të volitshëm se ai të të cilin e ka goditur.

c) Afati për paraqitjen e ankesës

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë është 15 ditë nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me Ligjin për Procedurën Kontestimore nuk parashihet ndonjë afat tjetër. Përjashtim bëjnë procedurat e posaçme kontestimore ku përcaktohen afate më të shkurtra. ***Afati për ankesë në porcedurë kontestimore është më i shkurtër se 15 ditë, kështu në pçorcedurë nga mardhënia e punës afati për ankesë është 7 ditë, në porcedurë nga kontestet për shkakë të pengimit të posedimit afati për ankesë është 7 ditë, në kontestet për vlera të vogla afati për ankesë është 7 ditë, kontestet për procedurën e dhënies së urdhërpagesës afati për propositim është 7 ditë kur vendoset lidhur me kambilain dhe 3 ditor kur vendoset lidhur me çekun dhe në kontestet tregtare afati për ankesë është 7 ditë.***

c) Përmbajtja e ankesës

Ankesa duhet të përmbajë:

- ✓ shkaqet e ankimit me arsyetim;
- ✓ deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar
- ✓ aktgjykimi kundër të cilit paraqitet ankimi
- ✓ nënshkrimin e paraqitjes së ankimit.⁴³

Nëse ankesa nuk i përmban elementet e paraqitura si më lartë, atëherë gjykata duhet të marrë aktvendim me të cilin e thëret ankuesi që mrenda afatit prej 7 ditësh ta plotsojë ankesën. Kundër aktvendimit për plotsimin e ankesës nuk lejohet ankesë. Po që se ankuesi brenda afatit prej 7 ditësh nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedh poshtë ankesën

d) Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

Me shkaqe të ankimit kundër aktgjykimit kuptojmë të gjitha shkaqet për të cilat, sipas LPK-së, pala mund ta godas atë me ankesë. Aktgjykimi mund të goditet:

- Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
- Për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike,
- Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore.⁴⁴

1.2. Ankesa kundër aktvendimit

Baza për ankesë dhe efektet

Neni 368. 1 i LPK-së parasheh që kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet, kurse (neni 368.2), po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Ankesa e paraqitur brenda afatit ligjor e pengon përmbarrimin e aktvendimit, në qoftë se me këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe, (neni 369.1).

Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë për ankesat kundër aktvendimeve

Neni 370 i LPK-së i parasheh dispozitat në vijim për vendosjen mbi ankesat kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore.

Gjykata e Apelit mund ta zgjidhë ankesën në këto baza:

- të hedhë poshtë ankesën si të pa afatshme,

⁴³ LPK neni 339

⁴⁴ LPK neni 342 parag 1-2

- të hedh posh si jo të lejueshme
- të refuzon ankesën si të pa themeltë dhe të vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë
- të aprovon ankesën dhe të ndrshoj aktvendimin e goditur
- të prish aktvendimin e goditur, e kur është nevoja ta kthej çështjen në Gjykatën Themelore.⁴⁵

2.MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE

LPK i njeh dy lloje të mjeteve të jashtëzakonshme juridike për të cilat mund të vendosë Gjykata Supreme dhe ato janë: Revizioni, (neni 372), Përsëritja e Procedurës (neni 392).

Revizioni -Revizioni është mjet i goditjes së jashtëzakonshme me të cilin pala godet për shkak të shkeljes së ligjit aktgjykimi e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë të dhëna sipas ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë, pala kanë të dejtë në afat prj 30 ditësh.⁴⁶

Revizioni nuk duhet parë vetëm si garanci më tepër se kontesti midis palëve do të zgjidhet drejtë por rëndësia e këtijë mjeti qëndron edhe në faktin se ai është mjet për njëjtësimin e praktikës gjyqësore, pasi që duke marr qëndrime më lidhje me një çështje Gjykata Supreme ndimon në vendimin e sajë gjykatat më të ulta, sepse ato zakonisht i respektojnë qëndrimet e sajë. Revizioni kundër aktgjykimit paraqitet si mjet i jashtzakonshëm, devulativ josupzpenziv, prekluziv i dyanshëm dhe i kufizuar.⁴⁷

Revizioni si mjet i jashtëzakonshëm është i kufizuar sepse mund të goditen vetëm vendimet e caktuara dhe për shkaqet e caktuara. Procedura për paraqitjen e revizionit është rregulluar me LPK-së. Për revizion vendos Gjykata supreme e Maqedonisë së Veriut.⁴⁸

Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Përjashtim nga ky rregull kemi në rastet kur revizioni paraqitet për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të bërë në gjykatën e shkallës së dytë, me ç’rast palët mund të paraqesin fakte dhe prova të reja nëse pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin ma herët.

Palët mundë të deklarojnë revizionin kundër aktgjykimit të shkallës së dytë nëse shuma e lëndës së kontestit të pjesës së hedhur poshtë të aktgjykimit tejkalon 500.000 denar. ⁴⁹Në përjashtim të ksaj, pa mar parasysht vleren e kontestit, revizioni është cdo her i lejuar:

⁴⁵ LPK neni 370 parag 1-2-3

⁴⁶ LPK neni 372 parag 1

⁴⁷ . Arsen Janevski dhe Dr. Tatjana Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile; E drejta kontestimore, f.413

⁴⁸ LPK neni 373

⁴⁹ LPK neni 372 parag 2

- në kontestet për asistencë
- në kontestet për kompenzim të dëmit për humbje të asistencës për arsye të vdekjes së dhënësit të asistencës
- në kontestet e mardhënies së punës në rastin e ndalimit të mardhënies së punës
- në konteste të të drejtave materijale dhe
- në kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përdorimin e zbulimeve dhe përparim teknik, mostrave, modeleve, dhe klisheve dhe të drejtës së përdorimit të firmës dhe emrit, si dhe në kontestet e garave jolojale dhe sjelljeve monopoliste.⁵⁰

Përsëritjen e procedurës - Është mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, i kufizuar, jo supspenziv, i dyanshëm dhe në disa raste demonstrativ. E drejta për të kërkuar përsëritjen e procedurës është e kufizuar në aspektin e vendimeve që mundë të goditen me këtë mjet goditjeje, në aspektin e shkaqeve për të cilat mundë të bëhet goditje e vendimeve si dhe në aspektin e afatit mbrenda të cilit mundë të ngritet ai.

Me anë të propozimit për përsëritjen e procedurës mund të kërkohet përsëritja e procedurave të përfunduara me vendim të formës së prerë. Procedura mundë të përfundoj me anë të aktgjykimit, me anë të aktvendimit me të cilën padia hedhet poshtë apo me aktvendimit në të cilin konstatohet se ka përfunduar procedura me anë të veprimeve disponibile të palëve.⁵¹

⁵⁰ LPK neni 372 parag 3

⁵¹ Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.104.

KREU III

ZGJIDHJA GJYQESORE E KONTESTEVE TREGTARE NE MAQEDONINE E VERIUT

1. Poedura e kontesteve tregtare

Procedura në konteste tregtare është procedurë e vecantë kontestimore e rregulluar me LPK (kreu tridhjetë neni 461-473), e cila aplikohet për zgjedhjen e kontesteve që krijohen në mardhëniet ndërmjet subjekteve juridik.

Bëhet fjalë për kontestet që kanë një vargë specifikash dhe kërkojnë njohuri të specializuara nga ana e atyre që i zgjedhin, ndërsa në anën tjetër për shkakë të shpejtësisë dhe sigurisë në zhvullimin e qarkullimit juridik në tregti duhet të zgjidhet sa më shpjetë që është e mundur. Në disa sisteme procedurale zgjedhja e kontesteve tregtare u është besuar gjykatave të specializuara- gjykatave tregtare, ndërsa tek ne këto zgjidhen nga ana e gjykatave me kompetencë të përgjithshme, sipas rregullave mbi procedurën kontestimore.

Pushtetin gjyqësorë në RMV-së e ushtrojnë:

Gjykatat themlore

Gjykatat e apelit

Gjykata administrative

Gajykata e lart administrative

Gjykata supreme.⁵²

Procedura në kontestet tregtatre mund të inicohet në tre mënyra edhe ato:

-Procedurës së ndërmjetësimit

-Procedurës së urdhërpagesës

-Procedura me padi

⁵² Ligji për Gjykata Gazeta Zyrtare e RMV-SË nr 58/2006 neni 22

2.Procedura e ndërmjetësimit MEDIACIONI- Rruga deri te e drejta

Ndërmjetësimi është procedurë (metodë) alternative e zgjedhjes së mosmarveshjeve, veprimtari jashtëgjyqësore e rregulluar me ligjë, e cila zhvillohet vullnetarisht nga palët. Në procedurën e ndërmjetësimit nuk ka një gjyqëtar që vendos për çështjen, por vendimi meret nga vet palët, ku palët në kontest zgjedhin një ose ma shumë persona të panshëm (ndërmjetësuesit) për të ndimuar palët në arritjen e një zgjedhje reciprokisht të kënaqshme të mosmarveshjes së tyre, shumë me shpejt dhe me lirë se në procedurë gjyqësore.

Mediacioni është një ndër metodat më të shpeshta të cilat aplikohen si metoda të zgjidhjeve alternative të kontesteve e cila është vlerësuar si mënyrë më e shpejtë, efikas dhe më ekonomik i zgjidhjeve të kontesteve, si dhe si mënyrë më e mirë e shkarkimit të gjykatave. Si rezultat i këtyre vetive, mediacioni i ka të gjitha predispozitat për t'u bërë mënyra dominuese e zgjedhjeve alternative të kontesteve.

a.Parimet e ndërmjetësimit

Vullneti i lirë i palëve- zhvillohet me vullnetin e lirë të palëve, i cili shprehet gojarisht me shkrim, në pajtim me ligjin.

Barazia e palëve- në këtë procedurë ka barazi ndërmejt palëve me të drejta dhe detyrimi të parapara me ligj.

Panshmëria dhe pavarësia- ndërmejtësuesi gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmejtësimit është plotësisht i pavarur dhe i panshëm.

Privatësia dhe konfidencialiteti- në këtë procedurë publiku përjashtohet. Kjo procedurë është e natyrës konfidenciale, deklaratat dhe të gjitha informacionet tjera lidhëhur me procedurën nuk mund të meren si dëshmi në procedurë të tjera.

b.Kontestet të cilat mund të zgjidhen me procedurën e ndërmjetësimit

Kjo procedurë zbatohet në mardhëniet kontestuese të subjekteve të së drejtës në raport juridiko pasuror, tregtar, familjar, të punës raste të tjera të kontesteve nga e drejtra pransore, siç janë të drejtat që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtës pransore përmes mardhënive kontraktuale apo të fituara përmes trashëgimisë, procedurat e falimentimit, raportet e tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojn vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive gjykatës, prokurorisë apo një organi tjetër kompetent.

Kjo lloj procedurë nuk zbatohet në raste që kanë të bëjnë me dhunë në familje, në pajtim me ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo mosmarveshje për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër.

c.Lëndët e përshtatçme për ndërmjetësimin nga e Drejta Tregtare

Kontestet tregtare mundë të referohen në procedurën e ndërmjetësimit sipas vlersimit të gjykatës dhe me pajtimin dhe vullnetin e lirë të palëve, disa nga kontestet tregtare janë:

- Kontestet e shkaktuara nga konkurenca e ndershme ose e pandershme
- Kontestet lidhur me mospërbushjen e kontratave tregtare të lidhura mes personit fizik dhe juridik
- Kontestet lidhur me kompenzimin në dëmit materijal dhe jomaterijal.
- Kontestet lidhur me kontratat e sigurimit
- Kontestet që rjedhin nga kontrata e kredisë
- Kontestet lidhur me markat tregtare etj.⁵³

d.Inicimi i procedurës së ndërmjetësimit

Kjo procedurë mundë të inicohet nga Palët, Gjykata, Prokuroria, apo organi tjetër kompetent.

e.Zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit

Kjo procedurë inicohet nën ndihmën e një personi të tretë, të kualifikuar dhe të panshëm, të zgjedhur nga vetë palët, palët kanë të drejt të zgjedhin një ose më shumë ndërmjetësues, të cilat janë Ndërmjetësues të licencuar nga Ministra e Drejtësisë.⁵⁴

Procedura e ndërmjetësimit konsiderohet se ka filluar zyrtarisht në datën kur palët dhe ndërmjetësuesi nënshkruajn marrëveshjen për fillimin e procedurës. Pasi të nënshkruhet nga ana e palëve ato do të caktojnë datën dhe kohën për mbajtjen e seancës së ndërmjetësimit.⁵⁵

f.Kohëzgjatja e procedurës së ndërmejtësimit

Kjo procedurë është shumë më e shpejtë se procedura gjyqësore, një lëndë e cila nuk mund të të zgjidhet me vitë në rrugë gjyqësore nëpërmjet ptocedurës së ndërmjetësimit mund të zgjidhet prej 90 ose me shumti 120 ditë.

⁵³ Ligji për ndërmjetësim 2 “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr 188/13, 148/15, 192/15 dhe 55/16, neni 1 paragraf

⁵⁴ LN neni 17 paragraf 1

⁵⁵ LN neni 15 paragraf 1

Kush mund të jetë ndërmjetësues dhe cili është roli i tij?

Ndërmjetësues është personi i cili është certifikuar dhe licencuar për ndërmjetësues nga Ministria e Drejtësisë. Qytetarët mund ta verifikojnë në Regjistrin publik të Ndërmjetësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, nëse një person është ndërmjetësues i licencuar. Nëse nuk mund të gjendet në Regjistrin publik të Ndërmjetësuesve, atëherë ai nuk është ndërmjetësues i licencuar.⁵⁶

Ndërmjetësuesi ka rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit dhe negocimit duke i orientuar palët drejt gjetjes së zgjidhjes më të mirë për ta. Ndërmjetësuesi lehtëson ose ndihmon palët e përfshira në konflikt për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga vetë palët, zgjidhje që shpreh vullnetin e lirë dhe të pa imponuar ose pa manipuluar duke respektuar legjislacionin në fuqi në arritjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Ndërmjetësuesi nuk ka kompetencë të vendos vet kushtet e marrëveshjes ose zgjidhjen e konfliktit sipas vlerësimit të tij.

Procedura e ndërmjetësimit përfundon:

1) me lidhjen e marrëveshjes me shkrim për zgjidhjen e marrëdhënieve kontestuese ndërmjet palëve, në ditën e lidhjes së marrëveshjes;

2) me deklaratë me shkrim të ndërmjetësuesit, pas konsultimeve me palët, se zhvillimi i më tutjeshëm i procedurës së ndërmjetësimit nuk është i leverdishëm (i arsyetuar) në ditën e dorëzimit të deklaratës me shkrim;

3) me deklaratë me shkrim nga palët drejtuar ndërmjetësuesit se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar në ditën e dorëzimit të deklaratës;

4) me deklaratë me shkrim nga ndonjëra nga palët në procedurë palëve tjera dhe ndërmjetësuesit se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar në ditën e dorëzimit të deklaratës;

5) me vdekjen e njëres nga palët në marrëdhënien kontestuese dhe

6) me heqjen e zotësisë së ndërmjetësimit që e ka udhëhequr procedurën.

Procedura e ndërmjetësimit përfundon në afat prej 60 ditësh nga dita e dhënies së deklaratës për fillimin e procedurës, pavarësisht nga rezultati i saj.⁵⁷

Efekt i juridik i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim

Marrëveshja e arritur në mes palëve referuar nga gjykata, nga prokurori, ose nga vet palët ka fuqinë e një dokumenti përmbarues.

Në qoftë se nuk mund të arrihet marrëveshje nëpërmjet kësaj procedure, atëherë ndërmjetësuesi jep deklaratë për mos arritjen e qëllimit të caktuar, dhe kështu procedura do të udhëhiqet në procedurë gjyqësore.

⁵⁶ LN neni 32

⁵⁷ LN neni 20

Procedura e dhënies së urdhërpagesës

Kur kërkespatria ka të bëjë me kërkesë në të holla që është bërë e realizueshme, e që provohet me dokument të besueshëm që i është bashkangjitur padisë (në origjinal ose në kopje) atëherë gjykata do të urdhëroj të paditurin që ta përmbush kërkesëpadinë.⁵⁸

- **Dokumenti i besueshëm**

Dokumente të besueshme konsiderohen:

- Dokumentet publike,
- dokumentet private, në të cilin nënshkrimin e debitorit e ka verifikuar organi kompetent për verifikime,
- Kambialet dhe qeçet me protest dhe fatur kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës,
- Esktraktet e verifikuara nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, faturat,
- Dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumentit publik.⁵⁹

- **Kushtet për dhënien e urdhërpagesës**

Nëse paditësi kërkon dhënien e urdhërpagesës në bazë të dokumenteve të besueshme, ai duhet të bëjë të besueshme egzistimin e interesit juridik për dhënien e urdhërpagesës.

Nëse paditësi ka dështuar të bëjë të besueshme intersin juridik, atëherë gjykata e hedh posh padinë si të palejueshme.

- **Dhënia e urdhërpagesës edhe nëse padisë nuk i është bashkangjitur dokumenti i besueshëm**

Kjo paraqet përjashtim nga rregullat e parapara në nenin 418 të LPK-së ngase udhërpagesa mund të lëshohet edhe nëse padisë nuk i është bashkangjitur dokumenti i besueshëm por me kusht që:

- Kërkesa në të holla e cila është objekt i kërkesë padisë të ketë arritur,
- Që kërkesa mos të kalojë shumën prej 60.000 denarë
- Që në padi të jenë theksuar baza juridike e kërkesës si dhe shuma e detyrimit si dhe
- Që të jenë theksuar provat me anë të të cilave mund të provohet vërtetësia e pretendimeve të padisë.⁶⁰

⁵⁸ LPK neni 418 parag 1

⁵⁹ LPK neni 418 parag 2

⁶⁰ LPK neni 419

- **Dhënia e urdhërpagesës edhe kur paditësi nuk ka kërkuar**

Gjykata do të jep urdhërpagesën edhe në qoft se paditësi me padi nuk e ka kërkuar dhënien e urdhërpagesës, nëse gjykata ka gjetur se janë plotsuar kushtet për dhënien saj.

- **Vendosja e pa konvokuar seancë gjyqësore**

Urdhërpagesën gjykata e jep pa konvokuar fare seancë gjyqësore dhe vetëm në bazë të materialit procedural të përmbajtur në padi. Në procedurë e dhënies së urdhërpagesës aktvendimi me të cilën aprovohet kërkesë padia jepet në formë të urdhërpagesës.

- **Përmbajtja e urdhërpagesës**

Nëse plotësohen kushtet që gjykata të jep urdhërpagesën, atëherë në urdhërpagesë gjykata do të shënoj:

- Se i padituri ka për detyrë, pasi të dërzohet urdhër pagesa me shkrim ta përmbushë kërkesën e padisë bashkë me shpenzimet gjyqësore që i ka caktuar gjykata,
- Që mbrenda (7) ditësh kurse për konteste lidhur me kambialin dhe cekun mbrenda (3) ditësh ta paraqesë prapësimin kundër urdhërpagesës dhe
- E paralajmëron të paditurin se prapësimi i paraqitur mer vonesë do të hedhet poshtë.

Urdhërpagesa u dërzohet të dy palëve, të paditurit në urdhërpagesë i dërgohet edhe padia së bashku me shkresat që i janë bashkangjitur padisë.⁶¹

- **Mos plotësimi i kushteve për urdhërpagesën**

Në qoftë se gjykata nuk e aprovon propozimin e padisë për dhënien e urdhërpagesës atëherë ajo do të vazhdojë procedurën e përgjithshme sipas padisë. Kundër aktvendimit me të cilën nuk aprovohet propozimi për dhënien e urdhërpagesës nuk lejohet ankimimi.⁶²

- **Prapësimi si mjet juridik të urdhërpagesa**

Urdhërpagesën e dhën, kundër saj mund të paraqitet prapësimi si mjet juridik mbrenda afatit të caktuar, me prapësim i padituri mund të pretendojë:

- Të vërtetohet se për dhënien e urdhërpagesës nuk kanë qenë të plotsuara prezumimet procedurale që i kërkon ligji për dhënien e urdhër pagesës,
- Se paditësit apo të paditurit i mungon legjitimi real apo
- Se kërkesa e paditësit ende nuk është bërë e kërkueshme.

⁶¹ LPK neni 420 parag 3-4

⁶² LPK neni 421 parag 1-2

Nëse urdhërpagesa është goditur vetëm lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale, atëherë ajo mundet të goditet vetëm me ankesë. Në qoftë se urdhërpagesa goditet pjesërisht atëherë për pjesën e goditur do të vazhdoj procedura sipas rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore, ndërkaq për pjesën për të cilën nuk është goditur urdhërpagesa, bëhet e plotfuqishme.

Kundërshtimi e vonuar jo të plot gjykata e hedh poash pa mbajtur sencë kryesore.

- **Konvokimi i seancës**

Në qoft se kundërshtimi është paraqitur brenda afatit ligjor, gjykata do të vlerësoj se nevojitet më parë të konvokoj seancën përdagitore, të konvokoj seancë përgaditore apo menjherë të konvekoj seancë kryesore.

Në seancën e konvokuar palët kanë të drejtë të paraqsin fakte dhe prova të reja prapësimi dhe kërkesat të cilat nuk i ka parashtruar më parë, paditësi me padinë e tijë ndërsa i padituri me prapësimin e tij.,

I padituri në seancë e konvokuar nuk ka të drejtë të parashtroj pretendim për kompetencën territoriale të gjykatës, këtë pretendim mundet të parashtroj vetëm prapësimin e tijë kundër urdhërpagesës.

Nëse gjykata shpallet jo kompetente në pikpajme lëndore atherë e anulon urdhërpagesën dhe pasi aktvendimi mbi kompetencën të behet i formëes së prerë lëndën ja dërgon gjykatës kompetente.

Nëse gjykata shpallet jo kompetente ne pikpamje territoriale ajo nuk e anulon urdhërpagesën, pasi që të bëhet aktvendimi i formës së prerë lëndën ja dërgon gjykatës kompetente.

Gjithashtu edhe sipas ndryshimeve të fundit të Ligjit për procedurën kontestimore urdhër pagesa parashihet të sillet edhe përmes noterit kompetent, procedura e cila inicohet nga ana e palës ku pala me propozim për sjelljen e urdhërpagesës e dërgon deri te noteri kompetent, ku i njejtë në bazë të dëshmimeve të bashkangjitur në propozimin e sjelljes së urdhërpagesës e sjell akvendimin për sjelljen e urdhërpagesës nga ana e noterit.

I njejtë akvendim i dorëzohet të paditurit ku i njejtë në afat ligjor të caktuar në aktvendim ka të drejtën për kundërshtim kundër akvendimit të sjellur nga ana e noterit. Në këtë rast me pranimin e kundërshtimit nga ana e noterit i njejtë lëndën bashkë me kundërshtimin e dorëzon në gjykatën kompetente për shqyrtim të kontestit.

Në qoftë se i padituri nuk e kundërshton vendimin e sjellur nga ana e noterit në afat ligjor i njejtë aktvendim bëhet i plotfuqishëm.

II.PROCEDURA E KONTESTEVE TREGATRE PARA GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

1.Inicimi i procedurës me padi

Procedura inicohet nga vet pala që është e përfshirë në kontest, si palë mund të jenë personi fizik dhe personi juridik.Në procedurë mundë të marrin pjes edhe personat që nuk e kanë aftësin e të qenurit palë, nëse e mer parasyshtë lëndën e kontestit dhe duke i plotsuar kushtet për marrjen e cilsisë së palës.⁶³

Në procedurë mundë të paraqiten më shumë paditës si bashkëkontestimorë, ki rast mundë të ndhohë vetëm nëse paditësit jan ne bashkësi juridike, nëse të drejtat e tyre respektivisht obligimet dalin nga baza e njëjtë faktiker dhe juridike, , lëndë e kontestit janë kërkesa respektivisht obligime nga lloji i njëjtë që bazohen mbi bazë themelore faktike dhe juridike të llojit të njëjtë edhe pse ekziston kompetencë reale dhe vendore në të njëjtin gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur dhe ajo është e përcaktuar me ligj tjetër.⁶⁴

Procedura në shkallë të parë fillon me arritjen e padisë, nga ana e të paditurit, nëse për të njëjten procedurë është inicuar padi nuk mund të inicohet padi tjetër, në qoftë se inicohet gjykata ka të drejtë ta hedh posht.

Sa I përket shpenzimeve procedural ligji e parasheh: pala që e humb kontestin është e obligaur ti përmbush edhe shpenzimet palës tjetër. Nëse pala pjesërisht ka sukses në kontestë, gjykata mundë të caktoj që se cilia palë ti bartë shpenzimet e veta, ose njëra pal tja kompenzoj palës tjetër shpenzimet.⁶⁵

Ndërsa sa I përketLigjit Për Procedurë kontestimore në nenin 155 palët në kontyest I bartin shpenzimet në mënyrë të barabart.

Kompetenca gjyqsore - Në procedurën gjygji gjykon në kufijt e kompetencës së vet reale të përcaktuara me ligjë.⁶⁶ Nëse me ligj nuk është përcaktuar kompetenca ekskluzive vendore e ndonjë gjygji tjetër, për tu gjykuar është kompetente gjygji që është kompetent vendor i përgjithshëm për të paditurin.Për gjykim me kompetenca vendore të përgjithshme është gjygji në rajonin e të cilit i padituri e ka vendbanimin.Nëse i padituri nuk ka vendbanim ne RMV, kompetente do të jete gjygji në të cilën i padituri ka vendqëndrimin.

⁶³ LPK neni 70

⁶⁴ LPK neni 186

⁶⁵ LPK neni 148

⁶⁶ LPK neni 27

Nëse i padituri përvec vendbanimit ka edhe vendë qëndrim në ndonjë vend tjetër, sipas rethanave supozohet se ai do të qëndroj në atë vend për kohë të gjatë, kompetente do të jetë gjykata në të cilën i padituri e ka vendqëndrimin.⁶⁷

Sipas LGJ kompetente në pikpaje lëndore për zgjedhjen kontesteve tregtare në të cilën të dija palët janë persona juridik ose organe shtetërore janë gjykatat themelore me kompetenca të zgjeruara.⁶⁸

Në LPK egzistojnë dispozita të vecanta për përcaktimin e kompetencës vendore të gjykatave për zgjedhjen e kontesteve tregtare. Kështu, për zgjedhjen e kontesteve për arsye të vërtetimit të egzistimit apo të mos egzistimit të marveshjesë, për arsye të egzekutimit apo prishjes së martveshjesë, si dhe në kontestet për arsye të kompenzimit të dëmit për arsye të mos egzekutimit të marveshjesë, krahas gjykatës me kompetenca të përgjithshme të vendit, kompetenca vendore është edhe gjykatat e vendit ku si sipas marveshjesë së palëve i padituri është i obliguar ta egzekutoj marveshjen.⁶⁹

Specificitetet e procedurës në konteste tregtare

Në procedurën në kontestet tregtare vlejnë rregulla të vecanta për pregaditjen e shqyrtimit kryesorë. Kur bëhet fjalë për raste urgjente, kryetari i këshillit është i autorizuar që:- menjëherë pas shqyrtimit paraprak të padisë, me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa, të caktoj seancë përgaditore ose seancë për shqyrtim kryesorë, pa mos ja dërguar padinë të paditurit për përgjigje me shkrim në padi, të caktoj seancë nëpërmjet telefonit ose telegramit.⁷⁰

Në procedurë në kontestet tregtare të dyja palët mundë me marveshjen të vendosin për shtyerjen e seancës me qëllim që të arrihet marveshje mes tyre.

Në këtë procedurë për kontestet tregtare vlejnë rregulla të vecanta për afatet, të cilat janë më të shkurt në krahasim me afatet e procedurës së përgjithshme kontestimore. Bëhet fjalë për afatet në vijim:

a) afati objektiv prej 30 ditësh për parashtrimin e propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme,

b) afat prej 8 ditësh për parashtrimin e ankesës kundër aktgjykimit, respektivisht aktvendimit,

c) afat prej 3 ditësh për parashtrimin e përgjigjes në ankesë dhe

⁶⁷ LPK neni 38-39

⁶⁸ LGJ neni 31 paragraf 2

⁶⁹ LPK neni 466

⁷⁰ LPK neni 468 paragraf 1-2

ç) afat prej 8 diteësh për përmbushjen e bërjes, ndërsa për bërje që nuk përmbushen prej dhënieve në të holla, gjykata mundë të caktoj afat më të gjatë.⁷¹

Për dallim nga procedura kontestimore në procedurën, në procedurën e kontesteve tregtare palët nuk mundë të japin deklara me gojë në procesverbal përpara gjykatës. Kjo do të thotë se, në këtë procedurë dominon parimi me shkrimi sa i përket farmës në të cilën ndërmeren veprimet procedurale.⁷²

Në procedurën për kontestet tregtare mundë të jepet urdhërpagesa e dokumentuar. Specifike e kësaj procedure është se dokumenti i besueshëm, në bazë të të cilit jepet urdhërpagesa nuk duhet të dorzohet në origjinal ose në përshkrim të verifikuar, por mjafton që përshkrimin e dokumentit të këtill të ketë verifikuar organi i autorizuar i personit juridik.

Në procedurë për konteste tregtare nuk mundë të jepet urdhërpagesa e padokumentuar.

LPK përmban dispozita të vecanta me të cilat përcaktohet kontesti tregtar me vlera të vogël. Këto janë kontestet në vijim:

- kontestet në të cilat kërkesë padia ka të bëjë në konteste në të holla që nuk e kalon shumën prej 300.00 denarë,
- konteste në të cilat kërkesë padia nuk ka të bëjë në të holla, kurse paditësi në padi thekson se pajtohet që në vend të përmbushjes së kërkesës së caktuar të pranojë një shumë të caktuar në të holla e cila nuk e kalon shtatëmbëdhjetë mijë denarë,
- kontestet në të cilat objekti i kërkesë padisë nuk është në të holla por dorzimi i një sendi të luajtshëm vlera e të cilit, të cilën paditësi e thekson në padi nuk e kalon shumën prej 300.000 denarë.⁷³

Disa specificitete janë përcaktuar edhe në aspekte të lejueshmërisë së revizionit në procedurën në kontestet tregtare. Sipas kriterit të vlerës kundër aktgjykimit të sjellë në shkallë të dytë në kontestet tregtare është lejuar revizioni nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të plotfuqishëm kalon shumën prej 1.000.000 denarë.⁷⁴

Zhvillimi i procedurës para gjykatës së shkallës së parë

Procedura para gjykatës së shkallës së parë përbëhet nga tri stadiumi:

Përgaditja e shqyrtimit kryesorë- Në procedurë gjykata vendos për kërkesë padinë, sipas rregullës, në bazë të shqyrtimit gojor të drejt për drejtë dhe publik. Shqyrtimi kryesorë paraqetë pjesë qendrore të procedurës kontestimore, gjatë së cilës formosohet mateërijali procedural dhe shqyrtohen të gjitha çështjet që janë me rëndësi për vendimin mbi kërkesëpadinë,

⁷¹ LPK neni 471

⁷² LPK neni 472 parag 1

⁷³ LPK neni 473

⁷⁴ LPK neni 469

në shqyrtim kryesorë gjykata duhet të koncentrohet në çështje të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me kërkesat e palëve.

Shqyrtimi kryesorë fillon menjher pas pranimit të padisë në gjykatë. Përgaditja e shqyrtimit kryesorë përfshin më tepër aktivitete që përcaktohen edhe si faza të përgaditjes së shqyrtimit kryesorë.

- A. Shqyrtimi paraprak i padisë
- B. Dergimi i padisë deri tek i padituri për përgjigje
- C. Mbajtja e seancës përgaditore
- D. Caktimi i shqyrtimit kryesorë.⁷⁵

Me përgaditjen e shqyrtimit kryesorë udhëq kryetari i kshillit ose gjyqtari individual.

Vendimi i cili sillet nga kryetari i kshillit nuk ka të drejtë ankese dmth ky vendim është i plotfuqishëm dhe nuk ka të drejtë të atakohet.⁷⁶

Shqyrtimi kryesorë- është stadium qendrorë i procedurës së shakllës së parë. Shqyrtimi kryesorë paraqet tërsi të veprimeve procedurale të gjykatës dhe palëve që ndërmeren në njo ose disa seanca me qëllim që të grumbullohet matreijali procedural dhe të formosohet premisa e poshtme e vendimit mbi bazën e kërkesëpadisë.

Shqyrtimi kryesorë nazohet në më shumë parime që janë themelet e procedurës..Shqyrtimi kryesorë është shqyrtim me gojë, i drejtëpërdrejtë dhe publik për meritumin e kontestit., këtu vejnë në shprehje barabartsia er palëve dhe kontradiktorialiteti në shqyrtim.

Shqyrtimi kryesorë mundë të mbahet vetem nëse janë plotsuar kushtet e përcaktuara.

SI kushte qe mundë të cekën janë se pala duhet të njoftohet për mbajtjen e shqyrtimit dmth të jenë të ftuar në mënyrë të rregullë, mos ardhja e ndonjëres pal në shqyrtim kryesorë prodhon efekte të caktuara juridike-procedurale.

Zhvillimi i shqyrtimit kryesorë- Shqyrtimin kryesor e mban kryetari i kshillit apo gjyqtari individual. Së pari e shpall objektin e shqyrtimit pastaj e vërteton a kanë ardhur të gjithë personat e ftuar. Kur kryetari vërteton se janë plotsuar të gjitha kushtet për shqyrtim e hap shqyrtimin kryesorë.

Nëse nuk është mbajtur seanca përgaditore do të fillohet menjherë me paraqitjen e padisë, pastaj i paditur përgjigjet në pretendimet e padisë.

⁷⁵ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f357

⁷⁶ LPK neni 263 parag 2

Nëse nuk është mbajtur seanca përgaditore të gjithë palët bë paraqitjen e vet duhet ti paraqesin të gjitha faktet e nevojshme për arsyetimin e propozimeve të veta, të ofroj prova të nevojshme për vërtetimin e pretendimeve të veta si dhe deklarohet për pretendimet dhe provat e pretenduara nga pala kundërshtarë.

Në stadiumin e hqyrtimit kryesorë, drejtimin në procedurë, ligji e quan udhheqje me shqyrtimin kryesorë.

Udhheqja me shqyrtimin kryesorë i përfshin veprimet nëpërmejt të cilave gjykata e drejton fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e shqyrtimit kryesorë. Sikurse drejtimi i procedurës në përgjithësi, udhheqja me shqyrtimin kryesorë mundë të jetë:

- Formale- i përfshin veprimet që kanë të bëjnë me zhvillimin kohor të shqyrtimit kryesorë,
- Material- i përfshin veprimet për shqyrtimin të bazës së kërkesëpadisë.

Kryetari i kshillit ka autorizime si për udhheqjen formale ashtu edhe për at materiale të shqyrtimit kryesorë. Kështu kryetari i kshillit e hap shqyrtimin kryesorë, e shpall objektin e shqyrtimi, vërteton se a kanë ardhur të gjitha personat e ftuar, i dëgjon palët, egzaminon prova, u jep fjalën antarëve të kshillit, palëve përfaqësuesit të tyre ligjor apo përfaqësuesve me prokurë dhe i shpall vendimet e kshillit.⁷⁷

Kryetari i kshillit është i obliguar të kujdeset për objektin e kontestit që të shqyrtohet nga të gjitha anët, për këtë shkak mos zgjatet procedura, në mënyrë që shqyrtimi sipas mundësis të përfundoj në një seancë.

Vendosja për shpenzimet procedurale

Në shqyrtimin kryesorë shqyrtohet dhe vendoset sipas rregullës, për meritumin e kontestit, objekt i shqyrtimit dhe vendosjes mundë të jetë edhe çështje me natyrë procedurale, për këtë çështje gjykata vendosë në bazë të kundërshtimit të ndonjërit nga palët ose sipas detyrës zyrtare.⁷⁸

Fjalët përfundimtare

Pas egzaminimit të të gjithë provave dhe drejtëpërdrejtë para përfundimit të shqyrtimit kryesorë, gjykata u jep mundësi palëve që ti thonë fjalët e veta të fundit. Fjalët e fundit të palëve paraqesin një përmlendhje të shkurtër të palëve para gjykatës, gjatë së cilës palët i rrezymojnë aspektet faktike dhe juridike të objektit të kontestit.⁷⁹

⁷⁷ LPK neni 297

⁷⁸ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f365

⁷⁹ LPK neni 289

Paraqitjen e vet drejtuar gjykatës së pari e ka paditësi e më pas i padituri. Me fjalët përfundimtare palë definitivishtë i formulojnë kërkesat e veta për mbrojtje që i drejtojnë gjykatë.

Përfundimi i shqyrtimit kryesorë

Kur gjykata do të kontestoj se objekti është shlyrtuar mjaft, ashtu që çështja juridike lidhur me të cilën zhvillohet procedura është gati për vendim, kryetari i kshillit do njoftojnë se shqyrtimin kryesorë ka përfunduar.

Aktvendimi për përfundimin e shqyrtimit kryesorë e se jll këshilli, respektivisht gjyqtari individual.Përfundimi i shqyrtimit kryesorë është moment më i rëndësishem në zhvillimin e procedurës me të cilat lidhen pasojat e caktuara juridike-procedurale. Deri në përfundimin e shqyrtimit kryesorë:

- Palët mundë të paraqesin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja,
- Paditësi mundë të tërheq padinë,
- I padituri ka mundësi që me pajtimin e paditësit të paraqesë kundërpadi, ndërsa me pajtimin e tijveëm nëse gjykata ka lejuar ndryshimin e padisë,dhe pse i padituri e ka kundërshtuar atë,
- Paditësi mundë të ndryshojë padinë në kuptimin subjektiv.⁸⁰

Përfundimi i procedurës së shkallës së parë

Kjo procedurë mundë të kaloj në të gjitha fazat e përcaktuara me ligj por mund edhe të përfunoj në ndonjëren nga këto faza.

Kjo procedurë mundë të përfundoj me aktvendim që në fazën e pregaditjes së shqyrtimit kryesorë, ose në vetë seancën për shqyrtimin kryesorë, kjo procedurë mundë të përfunodoj edhe fazat paraprake të procedimit dhe në bazë të ndonje veprimi dispozitiv të palëve (tërheqja e padisë, pranitim i kërkesë padisë, lidhja e pajtimit gjyqsorë dhe të ngjajshme).

Vedimet meritorë munde të sillen në formë të **Aktgjykimit** dhe **Aktvendimit**.

Aktgjykimi

Është një lloj i vendimit gjyqësorë me anë të të cilit vendose për çështje kryesore dhe për kërkesat e dorës së dytë. ⁸¹ Aktgjykimi definohet si akt i gjykatës me të cilin sipas rregullës pas përfundimit te shqyrtimit kryesorë vendoset për çështjen kryesore që është objekt i lëndës.

Aktgjykimi është vendim përfundimtar i procedurës me te cilën sipas rregullës përfunon procedura e shkallës së parë. Aktgjykimi është vendim meritorë se me anë të tijë, vendoset se a e meriton pala mbrojtjen juridike që e kërkon nga gjykat.

⁸⁰ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f368

⁸¹ LPK neni 311

Aktgjykimi është akt individual me të cilën zgjidhet kontesti që është objekt procedurës tregtare.

Procedura e sjelljes së aktgjykimit- procedimi është operacion i ndërlikuar mendor i gjykatës. Bëhet pjalë për kryerjen e një operacioni logjik silogjistik, në të cilën aktgjykimi paraqitet so përfunim i dy premisave: premisa e poshtme në të cilën e përbën gjendja faktike e vërtetuar nga ana gjykatës dhe premisa e lartë me të cilën e përbën norma juridike nën të cilën vendoset, respektivisht se cilës i përgjigjet gjendja faktike e vërtetuar.⁸²

Aktvendimi

Është lloji I venimit të cilën e sjell gjykata në procedurë kontestimore në rast kur ajo nuk vendos me aktgjykim. Sipas rregullës me aktvendim gjykata vendos për çështje procedurale, kurse me përjashtim me aktvendim gjykata vendos edhe për meritumin e kontestit, edhe në disa procedura të vecanta kontestimore-procedura për pengimin e posedimit dhe procedura për dhënien e urdhërpagesës.

Aktvenimi me të cilën në procedurë për dhënien e urdhërpagesës pranohet kërkespadija ka formë të urdhërpagesës.

Aktvenimet të cilat I sjell gjykata gjat procedurës mund të grupohen:

- Aktvendime për drejtim të procedurës
- Aktvendime me të cilat vendoset për prezumimet procedurale
- Aktvendime me të cilat vendoset për autorizime të palëve
- Aktvendim me të cilat ndalet procedura
- Aktvendime me të cilat vendoset në mënyrë meritore etj.⁸³

Aktvendimi sillet pas përfundimit të procedurës kontestimore, të gjitha aktvendimet që sillen në séance I shpall kryetari I këshillit, respektivisht kryetari individual dhe I përfshin në procesverbal.⁸⁴

⁸² Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f369

⁸³ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f387-388

⁸⁴ LPK neni 332

II.PROCEDURA E KONTESTEVE TREGATRE PARA GJYKATËS SË SHAKLËS SË DYTË

1.Inicimi i procedurës në shakllë të dytë

E drejta për ankesë është e drejtë e garantuar me kushtetutë: “Garantohet e drejta për ankesë kundër akteve juridike të vecanta të sejlla më procedurë të shkallës së parë përpara gjykatës, organit të administratës ose organizatës, ose institucioneve të tjera që kryejn autorizime publike”.⁸⁵

Ankesa mundë të paraqitet kundër cdo aktgjykimi të sjellë në shkallë të parë me ankesë mundë të goditet të gjitha llojet e aktgjikimeve të sjella në procedurë.

Ankesas është mjet i regullt juridik , i cili paraqitet kundër vendimeve që nuk janë të plotfuqishme, e që janë sjellë në shkallë të parë. Ankesa e paraqitur me kohë pengon që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm në pjesën që goditet me ankesë.⁸⁶

Ankesa është edhe mjet devolutiv.Për ankesën kundër aktgjykimit vendos gjykata e shkallës së dytë⁸⁷.

Ankesa është mjet juridik supspenziv , ajo e pengon paraqitjen e plotfuqishmërisë dhe përmbartshmërisë së aktgjykimit në pjesën në të cilën ai goditet me ankesë.

Ankesa është mjet juridik i dyanshëm.

Ankesa paraqitet në afat prekluziv, afati në të cilën palët mund ta paraqesin ankesën, është 8 ditë dhe fillon të rjedhë nga dita kurë palës i dërgohet përshkrimi i aktgjykimit.

Sa i përket kontesteve tregatë ato kanë afate të vecanta për paraqitjen e ankesës.

Në konteste tregatë vlejn afatet vijuese:

- Afati prej 30 ditësh pas skadimit gjatë të cilit nuk mundë të parashtrohet me propozim për kthimin e gjendjes së mëparshme.(Neni 110 paragraf 4 pas skadimit të tre muajve nga dita e lëshimit nuk mundë të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme).
- Afati prej 8 ditësh për parashtrimin e ankesës kundër aktgjykimit gjegjësisht vendimit, ndërsa afati prej tre ditësh për parashtrimin e përgjigjes së ankesës.
- Afati prej 8 ditësh për realizimin e bërjes ndërsa për bërjet që nuk përbëhen nga dhënia e parave, gjykata mundë të caktoj afat më të gjatë.

⁸⁵ Kushtetuta e RMV-së neni 15

⁸⁶ LPK neni 337 paragraf 2

⁸⁷ LPK neni 337 paragraf 3

Ankesa paraqitet nga pala që është e pa kënaqur nga vendimi i sjellur, pala ka të drejtë të paraqesë ankesën në afat prej 8 ditësh nga momenti nga dita e dërgimit të kopjes së aktgjykimit, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është përcaktuar.

2.Procedura sipas ankesës kundër aktgjykimit

Lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit veprojnë dy gjykata: gjykata e shkallës së parë që e ka sjellur aktgjykimin dhe gjykata e shkallës së dytë.

a.Procedura para gjykatës së shkallës së parë

Procedura ankimore inicohet me parashtrimin e ankesës. Ankesën e paraqet anketuesi edhe atë deri te gjykata që e ka sjellur vendimin e shkallës së parë. Ankesa paraqitet me numër të mjaftueshëm të shembujve për gjykatën dhe për palën kundërshtare.⁸⁸

Kompetencë funksionale për të vepruar sipas ankesës kundër aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë ka gjyqtari individual ose kryetari I kshillit, ai e shqyrton ankesën në aspektin juridiko- formal a është e lejuar që të veprohet sipas ankesës së paraqitur, respektivisht a janë përmbushur parakkushtet e nevojshme procedural që të mundë të vendoset në mënyrë meritore për ankesën. Duhet të shihet se a është paraqitur në kohë ankesa a është e plotë dhe e lejuar.⁸⁹

Nëse ankesa nuk është paraqitur në kohë ose është jo e plotë gjyqtari individual ka të drejtë të hedh posh me aktvendim pa mbajtur senacë.⁹⁰

Nëse ankesa është jo e plotë gjykatësi duhet ta thëret anketuesit që në afat të caktuar ti evitoj mungesat të ankesës, nëse anketuesi nuk paraqitet në afatin e caktuar për evitim të mungesave gjykatësi sjell aktvendim dhe e hedh poshtë ankesën.

Nëse ankesa është paraqitur në kohë është e plotë gjykatësi është i obliguar një kopje të dërgoj palës tjetër pasi që ankesa është e dyanshme, i dërgohet palës për përgjigje.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje në ankesë gjyqtari individual ose kryetari i kshillit ankesën dhe përgjigjen e ankesës së bashku me të gjitha shkresat ja dërzob gjykatës së shkallës së dytë.

b.Procedura para gjykatës së shkallës së dytë

Qëllimi i kësaj procedure është që të vendoset lidhur në bazën e ankesës.

Pas dorzimit të shkresave në gjykatën e shkallës së dytë menjëher përcaktohet gjyqtari raportues. Detyra e gjykatësit raportues është që të studiojë shkresat e çështjes ankimore dhe të përgadisë raport për gjendjen e çështjeve, të cilat do të nxjer para këshillit ankimorë.

⁸⁸ LPK neni 346

⁸⁹ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f404

⁹⁰ LPK neni 347 paragrafi 1

Gjyqëtari raportuesë ka mundësi që sipas nevojës të siguroj raport për shkejlen e dispozitave të procedurës dhe të kërkojë që të bëhen shikime me qëllim të vërtetimit të atyre shkeljeve.⁹¹

Në raport gjyqëtarui raportues nuk jep mendimin e vet lidhur me bazën e ankesës.⁹² Kompetente në pikpamje funksionale për të vendosur për ankesën në gjykatën e shkallës së dytë është këshilli ankimorë i përbërë prej 3 gjyqtarëve.

Gjykata e shkallës së dytë vendod sipas ankesës, sipas rregullës, pa shqyrtim respektivisht ne seancën e saj në të cilën marin pjesë vetëm antarët e këshillit dhe proces mbajtësi.

Përpara gjykatës së shkallës së dytë mund të mbahet edhe shqyrtimi. Kur këshilli i gjykatës i shkallës së dytë do të vlersojë se për shkak të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike është e nevojshme që të përsëriten provat që janë egzaminuar njëhere do të caktoj shqyrtimin përpara gjykatës së shkallës së dytë.⁹³

Duke pasur parasyshë ankesën në ankesë, në shqyrtimin përpara gjykatës së shkallës së dytë nuk mund të vërtetohen fakte të reja dhe të egzaminohen prova të reja.

Ka raste kur gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që ta hapë shqyrtimin. Kur në një seancë të këshillit ankimorë do të vërtetohet se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur ankesa bazohet në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës së kontesteve tregtare, ose në gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë ose të gabuar, ndërkohë që aktgjykimi njëhere ka qenë i anuluar, gjykata e shkallës së dytë do të caktoj shqyrtimin dhe do të vendosë në mënyrë meritore.⁹⁴

Nëse gjykata e shkallës së dytë vendos që ta hap shqyrtimin, në shqyrtim thiren palët, respektivisht përfaqësuesit e tyre ligjor, si dhe dëshmitarët dhe ekspertët për të cilën gjykata vendos se duhet të dëgjohen.

Mungesa e njëres ose e të dija palëve nuk paraqet pengesë për mbajtjen e shqyrtimit. Gjykata do të shqyrtojë ankesën dhe do ta sjellë vendimin duke pasur parasyshë vecanarishtë atë që është e parashtruar në ankesë dhe në përgjigjen në ankesë.

Shqyrtimi përpara gjykatës së shkallës së dytë zhvillohet sipas dispozitave për shqyrtimin kryesorë para gjykatës së shkallës së parë me disa specificitete të caktuara.

Shqyrtimi përpara gjykatës së shkallës së dytë fillon me raportin e gjyqëtarit raportuesë. Ai e paraqet gjendjen e çështjes duke mos i dhënë mendimin e vet lidhur me bazën e ankesës. Me pasë lexohet aktgjykimi ose pjesa e aktgjykimit me të cilën ka të bëjë ankesa., kurse sipas

⁹¹ LPK neni 350

⁹² LPK neni 352 parag 3

⁹³ LPK neni 351 parag 1

⁹⁴ LPK neni 351 parag 3

nevojës dhe procesverbali i shqyrtimit kryesorë përpara gjykatës së shkallës së parë. Me pas ankuesi e arsyeton ankesën e vet kurse pala kundërshtarë e arsyeton përgjigjen në ankesë.

Mënyrat e vendosjes sipas ankesës Neni 347 i Ligjit të Procedurës Kontestimore parasheh që Gjykata e Apelit, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj, ka diskrecion që të zgjidhë ankesën në njërin nga mënyrat si në vijim:

- ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
- ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore;
- ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;
- ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.
- ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur.⁹⁵

Gjykata e apelit e hedh padinë edhe në këto raste:

- Në qoftë se në procedurën e shkallës së parë ka vepruar, si paditës apo i paditur, personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse
- Nëse palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo nëse palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor,
- Nëse përfaqësuesi ligjor, ose ai me prokurë, nuk i ka pasur autorizimet e duhura për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të veçanta, gjegjësisht nëse veprimet e caktuar të kryera në procedurë më vonë nuk i ka aprovuar vetë pala.

2.Përfundimi i procedurës në shkallën e dytë

2.1.Ankesa kundër aktgjykimit

Gjykata e shkallës së dytë mund të sjell aktvendim ose aktgjykim., tek të cilat vijneë në shprehje autorizimet kasatore ose autorizimet për revizionin të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së dytë është e autorizuar që të hetojë ankesën nga aspekti juridiko-formal .Gjykata e shkallës së dytë e vërteton se a janë përmbushur prezumimet procedurale për vendosjen meritore sipas ankesës, në rast kur gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një që te tillë.

Nëse gjykata e shkallës së dytë vërteton se ankesa nuk është paraqitur në kohë është jo e plotë ose e pa lejuar do ta hedh poshtë me aktvendim, nëse këtë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë.⁹⁶

⁹⁵ LPK neni 347

Me rastin e vendosjes për bazën e ankesës, gjykata e shkallës së dytë mundë të sjellë një nga vendimet në vijmë:

- Aktgjykim me të cilën do ta refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe do ta vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë, në rast se do të vlersoj se nuk egzistojnë shkaqe për të cilin aktgjykimi goditet, e as shkaqe për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.⁹⁷
- Aktvendimi me të cilat do të anulohet aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta kthejë lëndën në gjykatën e njëjtë të shkallës së parë ose do tja dërgoj lëndën gjykatës kompetente të shkallës së parë me qëllim të mbajtjes së shqyrtimit të ri kryesorë nëse: -vërteton se egziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore të natyrës absolute ose relative (neni 358 paragraf 1 i LPK) ose - konsideron se për shkakë të vërtetimit të së drejtë të gjendjes faktike duhet të mbahet shqyrtimi i ri kryesorë përpara gjykatës së shkallës së parë, përvec nëse ka vendosur vet të mbajë shqyrtimin (neni 359 paragraf 1 i LPK).Gjykata e shkallës së dytë do të anulohet gjykimin e shkallës së parë dhe do ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë me qëllim të mbajtjes të shqyrtimit të ri kryesorë edhe kur: 1 pala nuk e ka goditur aktgjykimin për shkakë të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por gjatë vendosjes lidhur me ankesën paraqitet dyshimi i bazuar nëse janë vërtetuar drejtë faktet mbi të cilat është bazuar aktgjykimi i shkallës së parë (neni 359 paragraf 2 i LPK) dhe – në senacat të këshillit ose në shqyrtimin vleron se me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të vërtetohen faktet ose të egzaminohen prova të cilat ankuesi pa sukses i ka propozuar para gjykatës së shkallës së parë (neni 359 paragraf 3 I LPK).kur gjykata e shkallës së dytë anulon vendimin e shkallës së parë dhe e kthen lëndën në gjykim të përsëritur në shkallë të parë për shkakë të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së dytë me aktvendim me do të vendosë dhe se cilat veprime të kryera të përfshiera në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore anulohen.
- Aktvendimi me të cilat do të anulohet aktgjykimin e shkallës së parë do ta hedh poshtë padinë për shkakë të shkeljeve të caktuara esenciale absolute të dispozitave të procedurës: 1) nëse vendosur për kërkesë në konteste për të cilat nuk bien në kompetencë të gjykatës dhe 2) nëse është vendosur për kërkesë në konteste për të cilat është duke rrjedhur procedura ose për të cilën më herët është gjykuar në mënyrë të plotfuqishme ose për të cilat tani më është lidhur pajtimi gjyqësorë (neni 358 paragraf 3 i LPK)
- Aktgjykim me të cilën do të ndrihojë aktgjykimin e shkallës së parë: 1) nëse në bazë të shqyrtimit ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar në aktgjykimin e shkallës së parë, 2) ose nëse gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në

⁹⁶ LPK neni 356

⁹⁷ LPK neni 357

mënyrë të gabuar dokumentat ose provat e egzaminuara në mënyrë të tërthortë, kurse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në këto prova, 3) nëse gjykata e shkallës së parë nga faktet që i ka vërtetuar ka nxjerë përfunim të padrejtë mbi egzaminimin e fakteve të tjera, ndërsa mbi ato faktë është mbështetur aktgjykimi dhe 4) nëse konsideron se gjendja faktike në aktgjykim e shkallës së parë është vërtetuar drejtë por gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materijale. ⁹⁸

2.2. Ankesa kundër aktvendimit

Ankesa kundër aktvendimit është mjet i rregullt juridik, prekluziv, i pakufizuar, devulativ e njëanshëm sipas rregullës supspenziv kjo dotë thotë se:

- A. Ankesa paraqitet kundër vendimeve jo të plotfuqishme të sjellë në shkallë të parë.
- B. Ankesa paraqitet në afatin e përcaktuar ligjor prekluziv. Afati për paraqitjen e ankesës është 8 ditë nga dita e dërgimit të aktvendimit të shkallës së parë.
- C. Ankesa kundër aktvendimit mund të paraqitet në të gjitha shkaqet për të cilat mund të paraqitet edhe ankesa kundër aktgjykimit.
- D. Për ankesën kundër aktvendimit vendos gjykata më e lartë e cila ka sjellë aktvendim të shkallës së parë.
- E. Ankesa kundër aktvendimit nuk i dërgohet kundërshtarit të ankuesit për përgjigje
- F. Ankesa kundër aktvendimit e cila është paraqitur në kohë e ndalon përmbarimin e aktvendimit nëse në LPK nuk është përcaktuar ndryshe. ⁹⁹

⁹⁸ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f411

⁹⁹ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f412

III.PROCEDURA E KONETSTEVE TREGTARE PARA GJYKATËS SUPREME

1.Inicimi i procedurës ne Gjykatën Supreme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është gjykata me e lartë në shtet dhe siguron barazinë në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave. Gjykata supreme e realizon pushtetin gjyqësorë në tërë territorin e Republikës dhe selinë e ka në Shkup.

Kompetenca

- Venods në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saj siç është e pararë me ligj
- Vendos në shkallë të tretë dhe të fundit sipas ankesave kundër vendimeve të gjykatës së apelit
- Venod sipas mjeteve të jashtzakonshme juridike kundër vendimeve të përfundimtare të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saj kur ajo është paraprë me ligjë
- Vendos për ndeshjen në mes kompetencave të gjykatave themelore të rajonit të gjykatave të ndryshme të apelit, ndeshje të kompetencave ndërmjet gjykatave të apelit, ndeshje në mes gjykatave administrative, ndeshje të kompetencave ndërmjet gjykatës së lartë administrative me ndonjë gjykatë tjetër dhe vendos për bartjen e kompetencës venodre te këtë gjykata
- Vendos sipas kërkesave të palëve dhe pjesmarësve të tjerë në procedurë e cenimit për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm, në procedurë siç është e paraprë me ligjë, para gjykatave të RMV sipas rregullave dhe principeve të parapara në Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe duke nisur nga praktika gjyqësore e gjykatës Evropiane për të drejtat e njerëzve dhe
- Realizon çështje të tjera me ligj.

Procedura në Gjykatën Supreme fillon me iniciimin e procedurës nga ana e palëve.

Vendimi i sjellur në Gjykatën e shkallës së dytë ka të drejtë të atakohet me mjetet e jashtëzakonshme, nga palët që janë të pa kënaqur.

Si mjete të jashtzakonshme paraqitet:

2.REVIZIONI SI MJETE JURIDIK I JASHTZAKONSHEM

Revizioni kundër aktgjykimit është mjete juridik, të cilin mund ta shfrytëzojnë palët në procedurë kontestimore, në radhë të parë me qëllim që të siguroj ligjshmëri juridiko-materiale dhe juridiko-procedrura të vendimit gjyqësorë mbi çështjen konkrete. Si përjashtim me anë të revizionit mund të relaizohet edhe qëllime më të gjëra juridiko-politike.

Revizioni kundër aktgjykimit është mjet juridik i jashtzakoshëm i cili paraqitet kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të sjellë në shkallë të dytë.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë paraprakisht duhet të jetë paraqitur ankesa në mënyrë që kundër aktgjykimit të gjyktaës së shkallës dytë të sjell sipas ankesës të mundë të parashtrohet revizioni.

Revizioni kundër aktgjykimit mund të paraqitet në afat të përcaktuar me ligj, pas kalimit të të cilit humbet e drejta që të paraqet revizion. Afati për parashkrimin e revizionit kundër aktgjykimit është 30 ditë nga dita e dërgimit të përshkrimit të aktgjykimit të plotfuqishëm.¹⁰⁰

Lejimi i Revizionit

Rregullat themlore sa i përket lejimit të revizionit kundër aktgjykimit është se pala mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të sjellë në shkallë të dytë.

Regjimi i lejimit të revizionit korigohet në mënyrë plotsuese me zbatimin e dy krytereve:

- Kryteri i vlerës- palët mundë të paraqesin revizion kundër aktgjykimit të shkallës së dytë , nëse vlera e objektit të kontestit të pjesës të pjesës së goditur të aktgjykimit kalon 500.000 denarë ¹⁰¹
- Kriteri Kauzal- pa marrë parasyshë vlerën e objektit të kontestit, revizioni është përherë i lejuar:
 - në konteste për mbajtje,
 - në konteste për kompenzimin e dëmit për shkakë të humbjes së mbajtjes në rast të vdekjes të dhënësit të mbajtjes, 3) në konteste nga mardhënia e punës për shkakë të pushimit nga mardhënia e punës,
 - në konteste nga e drejta e autorit, dhe
 - në kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përdorimin e shpikjeve dhe përparimeve teknike, mostrave, modulave dhe vulvave dhe me të drejtën e

¹⁰⁰ LPK neni 372

¹⁰¹ LPK neni parag 2

përdorimit të firmës ose titullit si edhe në kontestet nga garat joale dhe sjelljet monopolistike.¹⁰²

Pë procedura të veçanta kontestimore vlejné rregulla të veçanta sa i përket lejimit të revizionit. Kështu në kontestet tregtare revizioni kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të sjellë në shkallë të dytë është i lejuar vetëm nëse vlera e kontestit të pjesës së goditur të aktgjykimit të plotfuqishëm kalon shumë prej 1.000,000 denarë.

Në kontestet tregtare revizioni kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të shkallës së dytë është gjithmonë i lejuar në kontestet nga e drejta e autorit dhe në kontestet që kanë të bëjnë me mbrojtje dhe përdorimin e shpikjeve dhe përparimeve teknike, mostrave, modeleve dhe vulvave dhe me të drejtën e përdorimit të firmës dhe titullit si dhe në kontestet ga garat jolojale dhe sjellje monopolistike.¹⁰³

Shkaqet për revizion

Revizioni si mjet juridik i jashtëzakonshëm manifestohet edhe nga aspekti i shkaqeve për të cilat me revizion mund të gditet aktgjykimi i plotfuqishëm i shkallës së dytë.

Revizioni mundë të paraqitet vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkakë të zbatimit të gabuar të të drejtës materijale.¹⁰⁴

Me revizion nuk mund të goditet aktgjykimi i plotfuqishëm për shkakë të të vërtetimit të gabuar ose jo të plot të gjendjes faktike.¹⁰⁵

Paraqitja e revizionit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës gjithashtu është i kufizuar. Revizioni mund të paraqitet për shkak të shkeljeve esenciale absolute të dispozitave të procedurës përveç shkeljeve esenciale në vijim:

1. Nëse shkelja ka të bëjë me kompetencën vendore
2. Nëse ghykata e shkallës së parë ka sjell aktgjykim pa mbajtje të shqyrtimit kryesorë, ndërkoh që ka qenë e detyruar që të mbaj shqyrtimin kryesorë
3. Nëse është vendosur për kërkesë për të cilën është duke rjedhur procedura
4. Nëse në kundërshtim me ligjin, nga shqyrtimi kryesorë ka qenë i përjashtuar publiku.¹⁰⁶

¹⁰² LPK neni 372 paragraf 3

¹⁰³ LPK neni 469

¹⁰⁴ LPK neni 375 paragraf 1

¹⁰⁵ LPK neni 375 paragraf 3

¹⁰⁶ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f415-416

Procedura sipas revizionit kundër aktgjykimit-Revizioni kundër aktgjykimit ka efekt devulativ. Për atë vendos gjykata më e lartë nga gjykata që ka sjellë aktgrykimin që goditet me revizion. Revizioni nuk parashtrahet drejtpërdrejtë në gjykatën e revizioni por në gjykatën që ka sjellur aktgrykimin e shkallës së parë. Revizioni parashtrahet në numër të mjaftueshëm të shembujve për gjykatën por edhe për palën kundërshtare.

Gjykata e shkallës së parë e heton revizionin vetëm nga aspekti formal: se a është paraqitur në kohë, a është i plot a është i lejuar . revizioni i cili nuk është paraqitur në kohë, është jo i plot dhe i pa lejuar gjyqetari individual gjegjësisht kryetari i këshillit të gjykatës së shkallës së parë do të herdh posht me aktvendim pa mbajtur seancë.

Në qoftë se revizioni është i paraqitur në kohë është i plot dhe i lejuar, gjyqetari individualë apo këshilli gjyqësorë ja degon palës tjetër kundërshtare për përgjigje. Pala kundërshtare ka afat 15 ditë nga dita e dorzimit ta të parashtrajë përgjigje në padi.

Pasi që ta pala kundërshtare ta sjell përgjigjen e revizionit gjyqetari individual përgjigjen e revizioni së bashku me të gjitha shkresat nëpërmejt gjykatës së shkallës së dytë do tja dërgoj gjykatës së revizionit.

Kur revizioni së bashku me të gjithë shkresat e lëndës do të arrijë në gjykatën e revizionit do të përcaktohet gjyqetari raportues. Gjyqetari raportues ka për detyrë ta kontrolloj se a janë plotsuar kushtet për revizion nëse nuk janë plotsuar kushtet atherë sjell aktvendim me të cilën e hedh po revizionin.¹⁰⁷

Revizionit kundër aktgjykimit

Gjykata e revizionit mund të sjell disa lloje të vendimeve edhe atë:

1. Aktgjykimi me të cilën do të refuzojë aktgrykimin si të pabazuar, nëse vërteton se nuk egzistojnë shkaqe për të cilat revizioni është paraqitur. Duke pasur parasyshtë se aktgjykimi i shkallës së dytë i cili goditet me revizion është i plotfuqishëm, me anë të aktgjykimit me të cilën refuzohet revizioni si i pabazuar nuk vërtetohet aktgjykimi i shkallës së dytë. Arsyetimi i aktgjykimit me të cilën refuzohet revizioni si i pabazuar i përmban vetëm shkaqet që e arsyetojnë sjelljen e aktgjykimit të tillë.¹⁰⁸
2. Aktvendimin me të cilën do të anulojë plotësisht ose pjesërisht aktgrykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të gjykatës së shkallës së parë ose vetëm aktgrykimin e shkallës së dytë dhe lëndën do të kthjë në gjykim të përsëritur. këto vendime gjykata e revizionit do

¹⁰⁷ Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f417-419

¹⁰⁸ LPK neni 384 paragraf 1

të sjell nëse vërtetohet se ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës për shkakë të cilës mund të paraqitet revizioni.

3. Aktvendimi me të cilën do të anulohet aktgjykimi në gjykatës së shkallës së dytë dhe lëndën do të kthehet gjykatës së shkallës së dytë në gjykim të përsëritur, nëse vërtetohet se me aktgjykim është tejkaluar kërkesë padia është vendosur për dicka tjetër jo për atë që është kërkuar.
4. Aktvendimi që do të anulohet vendimin e shkallës së parë dhe të dytë dhe do të hedh posh padinë nëse është vendosur për kërkesë në kontest që nuk bje në kompetenca gjyqësore ose nëse është vendosur për kërkesën për të cilën më herët është vendosur në mënyrë të plotfuqishme, ose është lidhur pajtimi gjyqësorë.
5. Aktgjykimi me të cilin do të pranohet revizionin dhe do të ndryshojë aktgjykimin e goditur, atherë kur gjykata e revizionit vëretohet se është zbatuar gabimisht e drejta materijale.

Procedura pas sjelljes së vendimit sipas revizionit

Vendimi i gjykatës së revizionit nëpërmjet gjykatës së shkallës së dytë i dërgohet gjykatës së shkallës së parë. Për përsëritjen e procedurës përpara gjykatës së shkallës së parë në mënyrë përkatëse zbatohet dispozitat për përsëritje të procedurës së shkallës së parë që zbatohet rast të anulimit të aktgjykimit në procedurë sipas ankesës.¹⁰⁹

Gjykatës së cilës i është kthyer lënda për gjykim të përsëritur është e lidhur për çikpamjen juridike mbi të cilat mbështetet aktgjykimi i gjykatës së revizionit me anë të të cilit është anuluar aktgjykimi i shkallës së dytë, gjegjësisht edhe i shkallës së parë edhe i shkallës së dytë.¹¹⁰

Revizioni kundër aktvendimit

Është mjet juridik i jashtëzakoshmëm të cilën palët mundë ta paraqesin kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilën ka përfunduar procedura në mënyrë të plotfuqishme.

Sa i përket lejimit kundër aktvendimit LPK përcakton dy kufizime:

1. Revizioni kundër aktvendimit mund të paraqitet vetëm kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilën ka përfunduar procedura në mënyrë të plotfuqishme
2. Revizioni kundër aktvendimit është i lejuar në konteste me të cilat është i lejuar aktgjykimi i shkallës së dytë.

¹⁰⁹ LPK neni 390-366

¹¹⁰ LPK neni 386

2.PËRSËRITJA E PROCEDURËS

SI MJETE JURIDIK I JASHTEZAKONSHEM

Çdo procedim i përfunduar me vendim të formës së prerë (qoftë aktvendim apo me aktgjykim) mund të përsëritet me propozim të palëve kur për një që të tillë egzistojnë shkaqet e përmendura në nenin 392 i LPK. Propozimi për përsëritje e procedurës është mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, i kufizuar, josupspenziv i dyanshëm.

Procedura mund të përfudnoj me anë të aktgjyqimit ne anë të aktvendimit, me të cilën hidhet posh padia , apo me anë të aktvendimit me të cilën konstatohet se ka përfunduar procedura me anë të veprimit proceduralsisponibil të palëve.

Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendos si është shpjguar më parë gjykata e shkallës së dytë edhe atë gjyqetari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë.

Propozimi për përsëritjen e procedurës gjithmon i paraqitet gjykatës që e ka dhënë vendimin e shkallës së parë duke shprehur në prozim: bazën ligjore në mbështetjen e së cilës kërkohet përsëritja e procedurës, rethanat nga e cila rezullton se propozimi është paraqitur në afatin ligjor dhe mjetet provuese me të cilat arsyheton thëniet e propouesit.

Propozimi për përsëritjen e procedurës të paraqitur pas afatit ligjor,atë jo të plotë,apo të palejusheme, e hedh posh gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit pa mbajtur seancë gjyqësore.

Nëse gjykata e shkallës së par nuk e hedh posh propozimin atherë një egzemplarë ja dërgon palës kundërshtare, që ka të drejtë mbrenda afatit prej 15 ditësh të përgjigjet lidhur të.

Pasi të arrije përgjigja nga pala kundërshtare gjyqata se bashku me të gjitha shkresat ja dërgon gjykatës së shkallës së dytë mbrenda afatit prej 8 ditësh.

Gjykata e shkallës së dytë venods mbi propozimin për përsëritje e procedurës zakonisht jashë senace për shqyrtim kryesorë.

Në aktvendim me të cilën lejohet përsëritja e procedurës shqiptohet vendimi me të cilën anulohet ai i dhënë në proceduën e mëparshme.kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilën aprovohet propozimi për përsëritje të procedurës nuk lejohet ankimi.

Raporti në mes revizionit dhe Propozimit për Përsëritjen e procedurës-Në qoftë se në afatin për paraqitjen e propozimit të procedurës vetëm nga shkaqet për të cilat mundë të paraqitet revozioni do të konsiderohet se pala e ka paraqitur revizionin. Po që se pala paraqet revizionin për shkakun se në procedurën e shkallës së parë apo të shkallës së dytë është vendosur

mbi kërkesën për të cilën ka egzistuar vendimi i formës së prerë apo për kërkesën nga e cila paditësi ka hequr dorë në një procedurë të mëhershme apo për të cilën egzistoj ujdia gjyqësore dhe në të njejtën kohë apo më vonë paraqet propozim për përsëritjen e procedurës.

Në të gjitha rastet tjera në të cilat pala e paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës e pas kësaj e paraqet revizionin gjykata, zakonisht, e ndërpretë procedurën sipas revizionit derisa mos të përfundojë procedura sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, përveçse kur konstaton se ekzistojnë shkaqe të justifikueshme për veprim ndryshe.

Shkaqet për përsëritjen e procedurës -LPK-së parasheh që procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës: Në dispozita e nenit 392 parashihen shkaqet për përsëritjen e procedurës të numëruar në mënyrë taksative, por të cilat mund të klasifikohen në tri grupe:

➤ **Shkelja e dispozitave procedurale:**

- a) në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;
- b) vepra penale,
- c) Në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në tël cilin është verifikuar PËRMBAJTJA e pa saktë.
- d) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë të palës, kundërshtare apo të personit të tretë,
- e) fakte dhe prova të reja,
- f) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është bazar në një vendim tjetër gjyqësorë, ose në vendimin e ndonjë organi tjetër kurse ky vendim është ndryshuar prishur apo anuluar në mënyrë të prerë.
- g) Vendimi i gjykatës themelohet në bazë të deklaramit të rejshtëm të dëshmitarit apo ekspretit etj¹¹¹

➤ **Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës**

Sipas dispozitës së nenit 394 të LPK-së, propozimi për përsëritje mund të paraqitet brenda a në rastin:

- a) në rastin nga neni 392, paragrafi 1 pika 1 e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;

¹¹¹ LPK neni 392

- b) në rastin nga neni 392,paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;
- c) në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor të saj, e po që se përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, nga dita kur pala ka marrë dijeni për këtë shkak;
- d) në rastin nga neni 392, paragrafi 1 pika 4-6 e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për aktgjykimin penal të formës së prerë;
- e) në rastin nga neni 392, paragrafi 1 pika 7-8dhe 10 i këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për vendimin penal të formës së prerë, e nëse procedura penale nuk mund të zhvillohet, atëherë nga dita kur ka marrë dijeni për pezullimin e procedurës penale, apo për rrethanat për shkak të të cilave nuk mund të iniciohet procedura penale;
- f) në rastet nga neni 392,paragrafi 1 pika 9 e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak për përsëritjes së procedurës;
- g) në rastin nga neni 392,paragrafi 3 pika 10 të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur t’i parashtojë në gjykatë faktet e reja, gjegjësisht mjetet provuese të reja.¹¹²

¹¹² LPK neni 394

KREU IV

ANALIZE TE VENDIMEVE TE SHQIPTUARA NGA GJYKATA THEMLORE E GOSTIVARIT NE PERIUDHEN 2015-2020

Pas paraqitjes se kerkeses pran gjykates themelore ne gostivar siguruam gjithsejt pes aktvendime te cilet paraqiten si me posht dhe te cileve u behet analiz e pergjithsme.

Aktgjikimi nr 1:

Vendimi i sjellur në Gjykatën e Gostivarit kryesuar nga gjykatiësi individual, duke vepruar në bazë të padisë të parashtruar nga paditësi që në kët rast e kemi EVN-NË dhe pala e paditur paraqitet ndërmarrja për projektim inxhinering, ndërtim dhe shërbime A. MMPLUS DOO EKSPORT IMPORT , me bazë juridike borxh me vlerë 18.998.50 denarë.

Këtu kemi të paraqitur kundërshtimin nga ana e të paditurit kundër aktgjykimit për egzekutimin e dokumentit të besueshm e lëshuar nga ana e noterit. I padituri ne baz te vendimit te noterit ka qenë i obliguar që në afat prej 8 ditësh ta paguaj borxhin prej 18.998.50 denarë, borxhin të cilin e ka paguar por e ka paguar me vonesë, ndaj të cilit borxhë është paraqitur kamata.

Sa i përket pjesës se borxhit 18.998.50 denar Gjykata e shkallës së parë në Gostivar e shfuqizon vendimin e Noterit, me arsyetim se borxhi kryesor është pagur në tërësi nga ana e të paditësit, ngelet në fuqi vetem pjesa e kamatës.

Detyrohet që i padituri ndaj paditësit të paguaj kamaten 485.00 nga borxhi kryesorë , kamata është paraqitur për shkakë të vonesës së pagesës se fakturave të lëshuar nga ana e paditësit në këtë rasrt EVN-së.

ARSYETIMI

Pasi dorzohen të gjitha dokumentet e lendes në gjykat nga ana e noterit.

Duke vepruar në bazë të padisë së paraqitur nga paditësit kundrejtë të paditurit gjykatësi ka mbajtur senacë kryesore publike dhe gojore, në prezenc të avokatit të paditësit dhe në mungesë të të paditurit i cili është ftuar në mënyrë të rregull.

Avokati i paditësit mbetet ashtu siç është në padi, dhe në kërkesë padin, si dhe në precizimin e kërkesë padis, konstaton se kundërshtimi i të paditurit është i pa bazë, në lidhje me atë që thekson se borxhi kryesor është i paguar dhe për arsye se pagesa e borxhit kryesor është

bërë me vones gjoja se kan ngelur vetëm pagesën e kamatës, si dhe i propozon gjykatës që në këtë pjesë prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe vendimi i noterit të mbetet i plotfuqishëm.

Gjykatësi në seancën kryesore i lejoi dhe i prezantoi të gjithë dëshmitë edhe ato, listën e inspektimit, listën e interesit, një certifikatë nga regjistri - kartelë financiare, statusi aktual i paditësit dhe të paditurit, kundërshtimin e të paditurit, pra gjykata duke vërtetuar provat të gjithë së bashku dhe se cilën veç e veç në bazë të nenit 7 dhe 8 të LPK, vërtetoi gjendjen faktike.

Paditësi dhe i padituri kanë hyrë në detyrim ligjor ku paditësi e ka furnizuar të paditurin me energji elektrike dhe për këtë i ka lëshuar faktura, për shërbimin e përdorur deri në ditën e propozimit i padituri nuk e ka paguar në tërësi borxhin prej 18.998.50 denarë.

Në lidhje me dokumentet e besueshme të paditësi i cili deri te notari ka paraqitur propozim për ekzekutimin e dokumentit, në të cilën nga ana e noterit është sjellur aktvendim me të cilën lejohet ekzekutimi i dokumenteve të besueshme, me të cilën të cilin i padituri si debitor kryesorë është i detyruar tja paguaj borxhin me vlerë 18.998.50 denarë së bashku me kamatën e përcaktuar në bazë të Ligjit për mardhëniet e detyrimit, si dhe harxhimet procedurale me vlerë 5.076,00 denari.

Në afat të caktuar kundrejt vendimit të sjellur, është parashtruar kundërshtim për vendimin e sjellur nga ana e noterit si organ kompetent, i cili nuk ka reflektuar në gjendjen faktike, dhe duhet të tërhiqet, dhe me kundërshtimin i drejtuar për EVN-në, shihet qartë dhe me përgjegjësi vërtetohet se ndërmarja A.MMPLUS nuk ka borxhë dhe paraqitet si pronar i gabuar në vendet e matjes.

Në bazë të vërtetimit të gjendjes faktike a duke u bazuar në dëshmitë e prezentuara si dhe në zbatimin e drejtë të drejtës materiale gjykata vendosi si në dispozitivin e aktvendimit.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi e ka plotësuar detyrimin e tij kundrejt të paditurit të cilin e ka furnizuar me rrymë elektrike kurse i padituri duhet ta bëjë pagesën për harxhimin e rrymës elektrike, të cilin obligim e ka realizuar me vonë dhe ngel të paguaj interes prej momentit kur ka qen i obliguar të paguaj borxhin kryesor deri në datën e pagesës së borxhit kryesor në përqindje të paraparë me ligj.

Me rrasin e vendosjes, gjykata ka marrë parasysh pretendimet e theksuara të pandehurit në kundërshtim, pretendimet e të paditurit janë vlersuar nga gjykata si pjesërisht e bazuar dhe e mbështetur me prova se i padituri ka vepruar në përputhje me nenin 205 paragrafi 1 i LPK-së. njëkohësisht gjyqji e obligon të paditurin të paguaj shpenzimet procedurale me vlerë prej 485,00 denarë.

Kostatohet se gjykata ka sjellur vendim të drejtë dhe të ligjshëm pasi e obligon të paditurin për paguimin e interesit të borxhit të paguar me vonesë dhe me të drejtë e obligon edhe për shpenzimet procedurale.

AKTGJIKIMI nr 2

Vendimi i sjellur në Gjykatën e Gostivarit kryesuar nga gjykatiësi individual, duke vepruar në bazë të padisë të parashtruar nga paditësi që në këtë rast e kemi S.V.K DOO në falimentim, kundrejtë të paditurit Avokat D.V, për përcaktimin e pretendimeve të procedurës falimentues me vlerë..... me pranimin e padisë gjykata me datë 14.05.2019 vit ka sjellur vendimin si me posh, vendimi është sjellur pa mbajtjen e seqancës kryesore:

AKTGJIKIM

(Pa mbajtur seanc)

Pranohet padia nga ana e paditësit S.V.K DOO në falimentim.

Vërtetohet se veprimi juridik në favor të paditurit si kreditor zvaritës ndaj të cilit është bërë shkresë përmbaruese në bazë të nenit 169 nga Ligji i Procedurës Përmbaruese, në lidhje me pasurinë e paluajtshme të debitorit e regjistruar ne Agjensionin e Kadastrës për pasurinë e paluajtshme me nr.... nga viti..., nuk ka asnjë veprim ligjor në masën falimentuese.

Detyrohet A. K që të fshije regjistrimin e kryer të aksesit të përmbarimit me nr....., ne lidhje me pasurinë e paluajtshme të debitorit të regjistruar ne AKPP, i cili është regjistruar pas pranimit të urdhrit për përmbarim, e gjithë kjo ne afat 8 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij vendimit në mënyrë që të mos ketë përmbarim.

I padituri kërkesat e veta mund ti paraqesë sipas vendimit të përmbarimit, ti relizoj si debitor falimentues, por detyrohet drejtori i falimentimit që në afat prej 5 ditësh nga dita e pranimit të vendimit i padituri të evidentohet ne shemen tabelarabelëen si debitor falimentues për vërtetimin e kërkesave të tijë, nën frikën e përmbarimit të detyrimit.

A R S E T I M I

I Padituri pran gjikates parashtron padi kunder te paditurit per vertetimin e mospranimit te kerkeses ne proceduren falimentuese.

Pass pranimit te padis gjikata padin ia dorzon te paditurit per paraqitje te kundrshtimit te padis, i cili padin e pranon teresisht dhe i propozon gjikates qe te bjere aktgjikim pa mbajtur seanc per shkak te pranimit.

Gjigji pasi pranon kundrshtimin e padis dhe pas vlersimit te padis dhe deshmive konstaton se ne mes te paleve nuk edhte kontestuese gjendja faktike duke mar patrasish pranimin e padis nga i padituri dhe pasi qe pranimi seshte ne kundrshtim me 3 alineja 3 te LPK , si dhe ne perputhshmeri me nenin 270 alineja 4 dhe nenin 321 te LPPvendosi si ne dispozitivin e aktgjikimit. Gjitashtu per harxhimet procedurale gjigji vendosi qe te obligoj te paditurin ti pagoj harxhimet procedurale paditsit.

Sa i perket rastit konkret konstatoj se gjykatsi ka sjel Akgjikim te drejtë dhe te ligjshëm pasi qe i padituri e pranon padin e paditsit i cili nuk ka penges te disponimit te pranimi te padis.

AKTGJYKIMI NR 3:

Vendimi i sjellur në Gjykatën e Gostivarit kryesuar nga gjykatiësi individual, me propozim nga paditësi A. D kundrejt të paditurit C.C në falimentim, për përsëritjen e procedurës, ku si bazë juridike kemi shkaktimi i dëmit me vlerë denarë, në seancën e mbajtur në prezenë të avokatit të paditësit V.T dhe proces mbajtësi ligjor nga i padituri drejtori i falimentimit G.J.S me mbajtjen e seancës në ditë 11.07.2019 gjykata ka sjellur:

AKTGJYKIM

Propëzimi për përsëritjen e procedurës nga ana e paditësit kundrejt të paditurit në falimentim konsiderohet i tërhequr.

Provat e paraqitura në lëndë lejohen të njejtat të paraqiten në procedurë me numer të lëndës TS.....

ARSYETIMI

Deri te gjykata paditësi paraqet propozim për përsëritjen e procedurës kundrejt të paditurit në falimentim, si bazë ligjore shkaktimi i dëmit me vlerë..... denarë.

Me propozim të paditësit gjykata do të caktoj seancë në datë.....

Paditësi deri te gjykata dërzoi parashtrësë të shkruar, me të cilën propozimin për përsëritje të procedurës e tërheq dhe kërkon që provat e paraqitura të përdoren në procedurën me numër TS....

Përfaqësuesi ligor i të paditurit në seancën e mbajtur ra dakord për tërheqjen e propozimit nga ana e paditësit.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata i ka udhëzuar palët që shpenzimet të përcaktohen në procedurën e cila udhëqet me nr TS... paraprake për shkakë se e njejtat udhëqet ndërmejt palëve të njejtat dhe me vlerë të njejtat.

Ne rastin konkret gjykata ka sjellur aktvendim te drejt konform ligjit.

AKTGJYKIMI nr 4:

GJYKATA THEMELORE GOSTIVAR- gjykata civile e shkallës së parë kryesuar nga gjykatësi L.S gjyqëtar i vetëm, duke vepruar në mënyrë nga paditësi DPTU P..... DOOEL me EMBS..... dhe EDB... me vendqëndrim i përfqësuar nga Avokati i tij D.I kundrejt të paditurit N.P për mbirmbajtjen dhe ruajtjen e rrugëve magjistrale dhe regionale Shkup, për dëmin material pësues me vlerë, pa mbajtjen e seancës kryesore sjell venimin me datë 14,05,2020:

AKTGJYKIM

Padia e dërzuar nga ana e paditësit kundrejt të paditurit hidhet is e pabazë.

ARSYETIMI

Paditësi me datë 05.05.2020 paraqiti padin në gjykatë nëpërmjet Avokatit të tij kundrejt të paditurit për dëme material.

Duke u bazuar në bazë të nenit 47 të Ligjit për përmisim dhe ndryshim të Ligjit për Procedurën Kontestimore në nenin 461 pas paragrafit 1 i LPK shtoi edhe tre nene të reja, të cilat shprehin se - Në kontestet tregtare me kërkesë monetare që nuk e kalon vlerën 1.000.000 denari, për procedurën e cila inicohet me padi në gjykatë, palët janë të detyruara para paraqitjes së padisë në gjykatë, mosmarveshjen e tyre ta rregullojnë në rrugë të ndërmjetësimit .Para paraqitjes së padisë paditësi është i obliguar të paraqesë provë me shkrim të lëshuar nga një mediator, se mundësia për rregullimin e mosmarveshjes në rrugë të medimit nuk është e sukseshme.

Në rastin konkret padia e paraqitur nga paditësi me kërkesë montae e cila nuk e kalon 1.000.000 denarë e sjellur me datë ndaj të cilës nuk ka provë me shkrim nga mediatori që mundësia për rregullimin e ksaj mosmarveshje nuk është e sukseshme, detyrohet gjykata që padinë ta hesh si të pa bazë, duke e vlerësuar nenin me tre paragrafet e reja.

Nga kjo konstatojm se kontestete me vlerë e cila nuk e kalon 1.000.000 denarë para se të inicohet padia në gjykatën e shkallës së parë, me ndryshimet e ligjit duhet të kaloj në procedurën e ndërmjetësimit dmth të dërzohet tek një mediator.

Marveshja e arritur në mes palëve ka fuqinë e një dokumenti përmbarues.

Në qoftë se nuk mund të arrihet marveshje nëpërmjet kësaj procedure, atëherë ndërmjetësuesi jep deklaratë për mos arritjen e qëllimit të caktuar, dhe kështu procedura do të udhëhiqet në procedurë gjyqësore.

Konstatohet se gjykatësi ka sjellur vendim të drejtë që e ka hedhur padinë si të pabazë, ku së pari duhet të zhvillohet në procedurën e ndërmjetësimit nëse arrihet marveshje atëherë ai dokument ka fuqinë e një dokumenti përmbarues, nëse nuk do arrihet atëherë padia përsëri do të inicohet në gjykatë.

AKTGJIKIMI nr 5:

GJYKATA THEMELORE GOSTIVAR- gjykata civile e shkallës së parë kryesuar nga gjykatësi V.P. gjyqëtar i vetëm, duke vepruar në bazë të padisë nga ana e paditësit AA . kundrejt të paditurit T.K, për borxh me vlerë..... denarë në prani të përfaqësuesve të tyre, në seancën kryesore të përfaqësuesit i paditësit P D dhe përfaqësuesit i të paditurit Z.D më datë 12.11.2018 vit ka sjellur vendim si më poshtë:

AKTGJYKIMI

Kundërshtimi nga ana e të paditurit kundrejt aktvendimit për lëshimin e urdhërpagesës notariale e lëshuar nga ana e noterit me numër të caktuar, refuzohet si jo thelbësore.

Aktvendimi për lëshimin e urdhërpagesës nga noter F.T me të cilin kërkohet që të detyrohet i padituri tja paguaj shumën e caktuar paditësit si dhe me kamatë ligjore, mbetet në fuqi.

ARSYETIMI

Nga noteri F.T janë të dërguara në gjykatë shkrimet për propozim të paditësit për lëshimin e urdhërpagesës kundrejt të paditurit për borxhin me vlerë denarë së bashku me kundërshtimin e lëshuar në kohë kundrejt aktvendimit me të cilin është lëshuar urdhërpagesa.

Duke vepruar në bazë të kundërshtimit të paditësit gjykata mban senacë të hapur kryesore në të cilën përfaqësuesi i paditësit e propozon gjykatën që të pranohet kërkesë-padia në përgjithësi për shkakë se paditësi ka kryer punët në lëmin e ndërtimit për të paditurin, i padituri pjesërisht ka paguar vlerën e punëve të kryera kurse kurse pa paguar ka ngelur vlera e kësaj lënde të inicuar me kërkesë-padi.

Me përgjigje në padi i padituri i propozon gjykatës që kundërshtimin lëshuar kundrejt aktvendimit të noterit për urdhër pagesë të pranohet në përgjithsi dhe akvendimin e për urdhër pagesë të sjellur nga noteri ta deklaroj si të pafuqishëm për arsye se paditësi nuk i ka kryer punët të cilat i ka fakturuar domethënë të njejtat pun nuk i ka kryer në mënyrë siç duhet.

Në procedurën e provave të procedurës kryesore gjykata ka shtjelluar provat në vazhdim: inspektimin e vendimit për lëshimin e urdhërpagesës me numër.....statusi aktiv nga Regjistri Qendror, faktura me nr.....tre kartela analitike, komunikimi elektronik, kopje të fotografisë, konto kartela etj, dhe gjykata duke vlersuar të gjitha dëshminë së bashku dhe secilën veç e veç në bazë të nenit 7 dhe 8 të LPK e vërteton gjendjen faktive.

Të paditurit si kontraktor nga ana e investitorit është ndarë punë për kryerjen e instalimit hidro teknik në të cilën pjesë bijen edhe punët e hidroizolimit të çatisë.

I padituri si kontraktor dhe paditësi si nënkontraktor përmes inxhinierit K kanë lidhur kontratë gojore për kryerjen e instalimit hidroteknik dhe punë për hidrolizimin e çatisë, i padituri me kërkesë të paditësit i ka kryerë punët në objektin P4, për punët e mbaruara paditësi i lëshon faktur me numër dhe vlerë denarë, nga e cila objekti lëndës është pjesë e pa paguar me vlerë..... vlerën të cilën i padituri është i obliguar ta paguaj në afat prej..... nga dita e lëshimit të fakturës.

Për arsye se i padituri vlerën e kësaj lënde nuk e ka paguar në kohë i njejtë është vonuar me pagesën për të cilën ka qen i obliguar që të ia paguaj paditësit interesin ligjor duke llogaritur nga deri në ditën e pagesës përfundimtare.

Gjatë gjithë rrjedhjes së procedurës së gjykimit, i padiskutueshëm është fakti se paditësi ka qen nënkontraktor i punëve hidraolike në spitalin F.B.

Gjykata në bazë të shqirtimit të dëshmimeve dhe deklaratave të palëve si dhe deklaratat e dëshmitarëve konstatoj se kundërshtimi është i pabaz, gjithashtu konstaton se i padituri nuk e ka kryer pagesën në bazë të fakturës, por i njejtë ka paguar vetëm një pjesë të fakturës ku pjesën e ngelur me kundërshtimin e kundërshton se paditësi punët nuk i ka kryer në mënyrë kualitative.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktive konstaton se i padituri punët e paraparë në faktur i ka kryer ndërsa në lidhje me atë që i padituri thekson se nuk i ka kryer në mënyrë kualitative janë të pa rëndësishme në këtë kontest, për arsye se nëse i padituri punët i ka kryer në mënyrë jo kualitative i padituri të drejtën e tij mund ta kërkoj me padi për dëm shpërblim për kryerjen jo kualitative të punëve.

Në bazë të lartpërmendurës gjykata ka vendosur në bazë të dispozitivit të këtij vendimi.

BIBLOGRAFIA

I-LIBRA

-Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009

-Shimac, S. "Mirenje-Alternativni način rjeshavanja sporova", Zagreb, Informator nr. 5404, 2005 E Drejta Procedurale Kontestimore. Autor: Arsen Janjevski. Shkup. 2009;

-F. Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë. 2004.

-A. Aliu, E Drejta Sendore (Pronësia), Prishtinë. 2009.

-A. Aliu, E Drejta Familjare. Autor, Prishtinë. 2007.

-A. Jashari, E. Osmanaj, Ankesa kundër aktgjykimit në procedure kontestimore, Vizione NR. 22/1. 2014.

-A. Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë. 2010.

-E. Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009

II-BURIME TJERA

Kushtetuta e RMV-SË

Ligji për procedurën kontestimore (LPK) "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr 79/2005

Ligji për falimentim neni 1 "Gazeta zyrtare" nr 34 22.03.2006

Ligji për pronsi dhe të drejtat tjera sendore "Gazeta zyrtare e RMV-se nr 18/2001

Ligji për Gjykata Gazeta Zyrtare e RMV-SË nr 58/2006

Ligji për ndërmjetësim 2 "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr 188/13, 148/15, 192/15 dhe 55/16

Kodi i Procedurës Civile i Shqipërisë.

Kodi Civil i Shqipërisë.

Ligji për procedurën kontestimore, Ligji Nr. 03/L-006, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30.06.2008, shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 29.07.2008 ;

Ligji për procedurën kontestimore i Republikës së Maqedonisë. *.(Gazeta zyrtare e RM,21 shtator 2005).*

Ligji për procedurën jokontestimore i Republikës së Kosovës;

Ligji për procedurën jokontestimore i Republikës së Maqedonisë.

Ligji i punës i Republikës së Kosovës.Nr.03/L -212.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Kosovës.Nr. 03/L-15.

Ligji për Arbitrazhin i Republikës së Kosovës. Nr. 02/L-75

Ligji për familjen i Republikës së Kosovës. Nr.2004/32

Ligji i punës i Republikës së Kosovës.Nr.03/L -212.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Kosovës.Nr. 03/L-15.

Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike- pronësore.Nr.827.Beograd.1980.

Ligji për Arbitrazhin i Republikës së Kosovës. Nr. 02/L-75

Ligji për familjen i Republikës së Kosovës. Nr.2004/32

Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 10 i këtij ligji.

Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.

Raporte

Manual Trajnimi“Arbitrazhi”(2014).USAID.Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial.

Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. USAID.(2007).
Shih. <http://ëëë.drejtësia-ks.org/?cid=1,41>